





Guida Interpretuese

Ndajmë Trashëgiminë Tonë me Njerëzit



Thorsten Ludwig



Thorsten Ludwig

Guida Interpretuese

Ndajmë Trashëgiminë Tonë
me Njerëzit

Bildungswerk
interpretation



Mbështetja e Komisionit Evropian për prodhimin e këtij botimi pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të mbahet përgjegjës për çdo përdorim ndaj informacionin që gjendet në të.

Bildungswerk interpretation
Am Rasen 23
D-37214 Werleshausen
Tel. +49-(0)5542-505873
www.interp.de

Autor:
Thorsten Ludwig
Titulli në original:
The Interpretive Guide – Sharing Heritage with People
Botuar në Gjermani nga:
Bildungswerk interpretation, Werleshausen
Edicioni i dytë, 2015

Redaktim: Michael Hamish Glen
Vizatimet dhe dizajni: Philip Rutt
Përkthyer/redaktuar në shqip nga: Daniela Ruçi dhe Ogerta Ujkashi

ISBN 978-3-9815219-9-3

Tabela e përmbajtjes

7	Hyrje
8	Rreth projektit HeriQ
9	Trekëndëshi intepretimit
10	Katër Asat
12	Interpretuesit nxisin respekt për trashëgiminë
14	Interpretuesit i kthejnë fenomenet në eksperiencë
16	Interpretuesit nxisin ndjesi tek pjesëmarrësit
18	Interpretuesit ofrojnë rrugë drejt të kuptuarit më të thellë
20	Ndryshimi i formacioneve
21	Përdorimi i mjeteve ndihmëse
22	Pranimi i ndërhyrjeve
23	Kapërcimi i pengesave
24	Zgjerimi i horizontit
25	Qëndrueshmëria është e rëndësishme
26	Ndërlidhja e fenomeneve
27	Të planifikosh dhe të mbash mend rendin
28	Shënime praktike
30	Vlerësimi i një shëtitje interpretuese
31	Si vazhdohet më pas?
32	<u>Shtojca</u>
33	Fletë pune biseda interpretuese
34	Fleta shembull biseda interpretuese
35	Fleta e vlerësimit biseda interpretuese
36	Harta e koncepteve për një shëtitje interpretuese
37	Termet kyçe të udhërrëfimit interpretues

Kushtuar udhërrëfyesve - në parqe, në muze dhe në vende të tjera të trashëgimisë - të cilët në mënyrë të vazhdueshme frymëzuan këtë manual përmes ideve, testimeve dhe reagimeve të tyre. Vlerësimi dhe suksesi i tyre janë treguesit e pagabueshëm të përpjekjeve tona.

Trashëgimia jonë evropiane është e pafund: nga tempujt në jug, tek fjordet e veriut; dhe nga rezervatet e shpendëve të Danubit, deri te qarqet misterioze prej guri me pamje nga Atlantiku. Kjo është trashëgimia jonë. Ajo na jep sigurinë mbi prejardhjen tonë dhe na ndihmon të zbulojmë se ku po shkojmë.

Me kalimin e kohës, shumë evropianë, duke punuar si staf ose si vullnetarë në zona të mbrojtura dhe pyje, vende historike dhe muze, ose në kopshte zoologjike dhe botanike, janë përkushtuar për të nxjerrë në pah trashëgiminë tonë natyrore dhe kulturore dhe për të kërkuar mënyra më të mira të menaxhimit të së ardhmes tonë. Interpretimi i trashëgimisë ka si qëllim t'i mbështesë ata. Si një qasje e njohur në mbarë botën, ajo i fuqizon njerëzit të marrin nën zotërim trashëgiminë e tyre të përbashkët dhe të zbulojnë 'sënsin e vendit' të shumë vendeve të çmuara në kontinentin tonë Evropian.

Interpretimi i trashëgimisë është i lidhur ngushtë me historinë e parqeve kombëtare. Në vitin 1957, gazetari Freeman Tilden shkroi librin "Të Interpretojmë Trashëgiminë Tonë" për Shërbimin e Parqeve Kombëtare në Shtetet e Bashkuara. Në këtë libër, ai së pari përcaktoi interpretimin e trashëgimisë dhe përcaktoi parimet e saj. Në Evropë, që nga viti 2010, ne kemi krijuar organizatën tonë, Shoqatën Evropiane për Interpretimin e Trashëgimisë, të njohur si 'Interpret Europe', në të cilën shumë interpretues profesionistë ndajnë me njëri-tjetrin dhe zhvillojnë punën e tyre gjithnjë e më shumë.

Interpretimi i trashëgimisë përdor një sërë mjetesh komunikimi, por mënyra më e mirë mbetet kontakti i drejtpërdrejtë me njerëzit. Për këtë arsye, udhërrëfimi interpretues luan një rol të rëndësishëm. Ky manual është përgatitur për udhërrëfyesit interpretues për ta përdorur në të gjithë Evropën. Duke përdorur ushtrime të provuara dhe të testuara që plotësohen nga udhërrëfyesit vetë, dhe me sugjerime për vetë-vlerësim dhe trajnim nga kolegët, ky manual mbështet udhërrëfyesit në përmirësimin e aftësive të tyre dhe në zhvillimin e kompetencave të tyre.

Ne shpresojmë që ky manual të përdoret gjerësisht në parqe, muze dhe në shumë vende të tjera që kanë si qëllim përkujdesjen për trashëgiminë tonë. Ne jemi gjithmonë mirënjohës dhe të hapur për të marrë këshilla dhe sugjerime se si qasjet tona mund të përmirësohen më tej.

Thorsten Ludwig
Maj 2015



Ky manual është shkruar si pjesë e projektit të BE-së Leonardo HeriQ, një projekt i 'transferimit të inovacionit', iniciuar nga partnerët Bullgarë dhe mbikëqyrur nga Qendra e Zhvillimit të Burimeve Njerëzore në Sofje.

Organizatat partnere të HeriQ janë:

- ⇒ APARE – Association pour la Participation et l'Action Régionale, Francë
- ⇒ Bildungswerk interpretation, Gjermani
- ⇒ Heritage Interpretation Center, Bullgari
- ⇒ Istituto Pangea Onlus, Itali
- ⇒ Mediterranean Centre of Environment, Greqi
- ⇒ National Association for Small and Medium Business, Bullgari

HeriQ i ka rrënjët e saj në projektin e hershëm Leonardo TOPAS (Trajnimi i Stafëve të Zonave të Mbrojtura), në të cilin ishin të përfshira organizatat partnere të HeriQ nga Italia dhe Gjermania dhe që synonte të përcaktonte standardet e cilësisë për interpretimin e trashëgimisë në Evropë. Në kuadër të TOPAS-it, kursi pilot 'Aftësitë Themelore Interpretuese' u zhvillua në vitin 2003, bazuar në idetë e Programit të Zhvillimit Interpretues të Shërbimit të Parqeve Kombëtare të Sh.B.A-ve. Një nga sfidat e kursit TOPAS ishte të zbulohet, cilat nga përvojat më shumë se 50 vjeçare të punëve interpretuese në SHBA mund të transferoheshin në Evropë dhe ku mundeshin interpretuesit e trashëgimisë Evropiane të zhvillonin qasjet e tyre vetjake. Duke u bazuar në projektin TOPAS, u zhvilluan disa kurse të tjera në vende të ndryshme të Evropës, për të trajnuar dhe për të certifikuar interpretuesit e trashëgimisë në interpretimin personal, interpretimin jo-personal dhe planifikimin interpretues.

Në Gjermani, tre organizata kombëtare u bashkuan në vitin 2008 për të zhvilluar projektin e trajnimit ParcInterp. Pasi organizuan disa kurse testimi, ata ranë dakord mbi standardet, kriteret dhe kompetencat bazuar në rezultatet e TOPAS-it për të lidhur interpretimin me mësimet për qëndrueshmëri. Për arritjen e kësaj, ParcInterp është i njohur si një projekt model nga UNESCO.

Në vitin 2013, HeriQ më në fund filloi që të transferonte përvojat nga TOPAS-i dhe nga ParcInterp-i në vendet e tjera evropiane, duke u përqëndruar në dy qëllime:

- ⇒ të frymëzojë interpretuesit që të veprojnë si agjentë interpretues, duke ngritur rrjete mbështetëse për interpretimin e trashëgimisë për qëndrueshmëri.
- ⇒ për të trajnuar dhe për të certifikuar udhërrëfyes interpretues që synojnë të ndajnë trashëgiminë e tyre kryesisht me turistë nga jashtë vendit.


Ky manual ka si synim të mbështesë pikën e dytë të përmendur më lart. Ai është pjesë e një pakete trajnimi dhe certifikimi i lidhur me kursin 40-orësh të certifikimit HeriQ për udhërrëfyes interpretues. Kursi përfshin detyra shtëpie, si dhe provime me shkrim dhe praktike. Ai mund të përshtatet në situata të ndryshme, për shembull, duke e ndarë atë në deri në pesë pjesë, ose duke e përdorur si një modul brenda një kursi më të gjerë trajnimi. Kursi është testuar me sukses në Bullgari, Francë, Greqi dhe Spanjë.

Pasi u printua botimi i parë në gjuhën angleze i Udhërrëfyesit Interpretues, ai u publikua edhe në njëmbëdhjetë gjuhë të tjera. Të gjitha versionet dhe shumë më tepër informacione mund të shkarkohen falas në www.heriq.org

Trekëndëshi i interpretimit

Çfarë është me të vërtetë e rëndësishme për një përvojë interpretuese? Kjo pyetje ka ekzistuar prej shumë kohësh, jo thjesht prej dekadash, por me mijëvjeçarë. Njerëzit përpiqeshin në çdo kohë të krijoni lidhje me vende dhe objekte edhe pse ata vetë nuk kishin kontribuar në ndërtimin e tyre; dhe në çdo kohë ata morën epërsi nga njerëzit të cilët i mbështetën në kërkimin e tyre për përgjigje, edhe pse këta njerëz nuk mund të quhen 'interpretues të trashëgimisë'.

Kur njerëzit ndeshen me një vend ose objekt trashëgimie dhe më pas kthehen në rutinën e tyre të përditshme, a bëhet ky vend ose objekt i trashëgimisë më kuptimplotë për ta? A ndihen ata më të lidhur me të dhe a e kuptojnë se ai vend / objekt lidhet me jetën e tyre dhe me vendimet e tyre për të ardhmen? Çfarë e përcakton atë 'fushë magjike' brenda së cilës zhvillohet interpretimi i trashëgimisë?



*Unë do të interpretoj gurët,
do të mësoj gjuhën e
përmytjeve,
stuhive dhe orteqeve.*

*Do të bëhem mik me akullnajat
dhe kopshtet e egra dhe
do të shkoj sa më afër që
mundem drejt zemrës së botës.*

John Muir

Ne konsiderojmë tre gurë themeli si të rëndësishëm për çdo proces interpretues që nuk mund të realizohet nga një person i vetëm:

- ⇒ vendi ose objekti si eksperiencë
- ⇒ njerëzit që e provojnë eksperiencën
- ⇒ mënyrat e komunikimit që lehtësojnë interpretimin e tyre

Këto tre gurë themeli formojnë të ashtuquajturin trekëndësh të interpretimit.

Sidoqoftë, pyetja më kryesore është: Çfarë i lidh këto të treja së bashku? Çfarë e arrin atë rezultat që pjesëmarrësit, pas një përvoje interpretuese, të ndiejnë se tashmë ajo është pjesë e jetës së tyre?

Përpara se të fillojmë të flasim për parimet dhe aftësitë interpretuese, do të ishte mirë të ndalemi dhe të mendojmë për këtë pyetje.

Ushtrim: Të ndiejmë të domosdoshmen


Le të ndahemi në çifte dhe të nisemi për një shëtitje dhjetë minutëshe, të pavarur nga njëri-tjetri. Gjatë kësaj shëtitje, pjesëmarrësit brenda këtyre çifteve bisedojnë rreth dy pyetjeve:

1. Çfarë vlerësoj unë në jetën time në të vërtetë?
2. Përse unë e vlerësoj këtë gjë?

Pasi të jemi kthyer të gjithë, grupohemi në një rreth për qark një posteri që tregon trekëndëshin e interpretimit. Më pas fillojmë të diskutojmë mbi atë çfarë mund të na ndihmojë për të bashkuar të tre gurët e themelit.



Katër Asat



Ideja e trekëndëshit nuk është e re dhe as unike. Arsyeja pse përdoret kaq shpesh në interpretimin e trashëgimisë, ashtu si në shumë profesione të tjera, është se ofron një ilustrim të përshtatshëm për procese të ndryshme të komunikimit.

Sidoqoftë, një pjesë thelbësore e trekëndëshit të interpretimit qëndron në qendër të diagramit. Një element i katërt duhet të na tërheqë vëmendjen, por cili mund të jetë ky element i katërt? Çfarë është kaq e rëndësishme që njerëzit të fillojnë të vlerësojnë diçka me të cilën nuk kanë pasur ndonjë marrëdhënie të ngushtë më parë?

E vërteta më e madhe

Freeman Tilden, të cilin e përmendëm më parë, shkroi dikur: "Interpretimi është zbulimi i një të vërtete më të madhe se ajo që qëndron pas çdo fakti". 'E vërteta më e madhe' ishte një mënyrë për të përshkruar domethënien e cila i shton kuptim fenomenit natyror ose kulturor në majë të trekëndëshit.

Ju lutemi vini re se në këtë rast flasim për: 'një' të vërtetë dhe jo 'e' vërtetë, sepse çdo fenomen mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Mund të ketë kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm.

Ekzistojnë disa terma për të përshkruar dhe përcaktuar atë që nënkupton e vërteta më e madhe e Tilden. Pavarësisht nga rezultati që nxorrëm në ushtrimin e faqes 10, ajo që ndoshta mund të kuptohet është se në shumicën e rasteve nevojiten më shumë sesa fakte për të lidhur njerëzit me një vend ose një objekt. Për këtë arsye, Tilden e përshkroi interpretimin e trashëgimisë në vitin 1957, me përkufizimin më të cituar që është përdorur që atëherë, si:

"një aktivitet edukues i cili synon të zbulojë kuptimin dhe marrëdhëniet nëpërmjet përdorimit të objekteve origjinale, përvojës së drejtpërdrejtë, mënyrave ilustruese të komunikimit, sesa duke u fokusuar thjesht dhe vetëm tek komunikimi i informacionit si fakt".

Parimet e mira që realizohen nga interpretimi i trashëgimisë, dhe të cilat Tilden i nxorri kryesisht nga përvojat praktike të udhërrëfyesve që ai studioi, janë pjesë përbërëse e kursit tonë dhe këtij manuali.

Fuqia e dashurisë

Në kontekstin tonë, bën sens gjithashtu, të shikojmë në qendër të trekëndëshit dhe nga një këndvështrim tjetër. Ne mund të bëjmë pyetjen: Për çfarë ka nevojë me të vërtetë një udhërrëfyes interpretues për të bashkuar pjesët e ndryshme e për ti bërë ato së bashku?

Një fjalë e thjeshtë dhe e mirë për të përshkruar këtë mund të jetë: dashuria. Të paktën kjo është sugjeruar nga shumë autorë të ndryshëm në kohëra të ndryshme.

Një interpretues i trashëgimisë duhet patjetër të ketë

- ⇒ përkushtim për vendet ose objektet e tij / saj
- ⇒ përkushtim ndaj pjesëmarrësve të tij / saj
- ⇒ përkushtimin ndaj misionit të tij / saj


Nëse dikush është vërtet i dashuruar me këto tre elemente, ai / ajo mund të frymëzohet mjaftueshëm për të arritur aftësitë e nevojshme për t'u bërë një interpretues i mirë i trashëgimisë.

Pra, katër elementë janë të lidhur me trekëndëshin e interpretimit. Ne i quajmë këto elementë katër asat e interpretimit, dhe siç do të shohim më tej në këtë manual, katër pretendime mund të lidhen me këto katër asa:

- ⇒ për t'i kthyer fenomenet në përvoja
- ⇒ të provokojë dhe nxisë ndjesi tek pjesëmarrësit
- ⇒ të ofrojë rrugë drejt një kuptimi më të thellë
- ⇒ të nxisë respektin për të gjithë trashëgiminë

*Mendoj se përmbledhet në këtë mënyrë:
Ju duhet të jeni të dashuruar
me materialin tuaj,
dhe ju duhet të jeni në një mendje
me shokun tuaj.*

Freeman Tilden




Për ta përmbyllur, të punosh me trekëndëshin e interpretimit do të thotë të kërkes kuptime më të thella, të cilat ne i shprehim në formulimin e mesazheve të cilat ndodhen në qendër të diagramit - por gjithashtu duke i dhënë të njëjtin përkushtim secilit prej tre gurëve të tij. Përndryshe, potenciali i lartë që trashëgimia ofron për mësim joformal mund të humbasë.

Një kurator i përkushtuar vetëm në detyrën e tij / saj të ruajtjes mund të mos gjejë lidhjen e duhur me botën e vizitorëve të muzeut. Një menaxher profesionist i tureve, duke u përqëndruar thjesht tek njerëzit që kalojnë pushime të lumtura mund të mos e kuptojë se përvojat e tyre mund të frymëzojnë vërtet pjesëmarrësit. Një kryebashkiak i kënaqur nga prezantimi i qytetit të tij / saj të vogël mund të priret të humbasë detaje më të rëndësishme. Profesionistë të ndryshëm i qasen interpretimit të trashëgimisë nga drejtime të ndryshme dhe për këtë arsye ata mund të përballen me sfida të ndryshme. Nuk ka asgjë të çuditshme në këtë drejtim: ne të gjithë i dimë fushat ku ndihemi si në shtëpi dhe të tjerat të cilat duhet së pari t'i kuptojmë për veten tonë. Kurset tona më interesante janë ato ku marrin pjesë njerëz me prejardhje të ndryshme profesionale; ku të gjithë ne mund të mësojmë nga njëri-tjetri.

Këto ishin disa nga informacionet e para në lidhje me trekëndëshin e interpretimit, modeli mbi të cilin bazohet kursi HeriQ për udhërrëfyesit interpretues. Në pjesët vijuese, të katër asat do të shpjegohen më në detaje dhe do të sugjerohen ushtrimet për t'i bërë ato më të prekshme për punën tuaj.

Interpretuesit nxisin respekt për trashëgiminë



... mbrojtje përmes vlerësimit,
vlerësim përmes të kuptuarit,
dhe të kuptuarit përmes
interpretimi.

Conrad Wirth

Të bëhemi ambasadorë

Si udhërrëfyes interpretues, duke punuar në një peizazh të mbrojtur, një vend historik ose kulturor, një muze ose një kopsht zoologjik, ne jemi kujdestarë të trashëgimisë. Mbikëqyrja është një term kyç në interpretimin e trashëgimisë. Kapelja e rojes së parkut (rangers) në kartën e lojës (foto në të majtë) simbolizon kujdesin tonë për gjithçka që duhet të respektojmë dhe mbrojmë si trashëgimi, qofshin ato të prekshme si një livadh ose një katedrale, ose aq e paprekshme sa aroma e luleve të malit pas një reshje shiu ose muzika Gregoriane që jehon nga kupolat e katedrales.

Çfarë është trashëgimia jonë?

Padyshim trashëgimia ka të bëjë me atë që njerëzit duan të ruajnë, atë që duan të trashëgojnë nga brezat e kaluar - dhe atë që vlerësojnë. Njerëz të ndryshëm mund t'i kushtojnë vlera të ndryshme trashëgimisë, në përputhje me, për shembull, moshën e tyre ose prejardhjen e tyre kulturore dhe shoqërore; dhe vlera e trashëgimisë mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Trashëgimia mund të përkufizohet si e tillë nga një person i vetëm, nga një familje, nga një komunitet lokal, nga një shtet apo edhe nga një grup shtetesh. Trashëgimia Botërore do të thotë që Kombet e Bashkuara kanë rënë dakord që është në interes të mbarë njerëzimit që një tipar specifik të ruhet për brezat e ardhshëm.

Hyrja në zemër të çështjes

Udhërrëfyesit interpretues në të gjithë botën ndajnë së bashku përkushtimin e tyre për të frymëzuar pjesëmarrësit përmes trashëgimisë së tyre. Interpretimi i trashëgimisë mund të nënkuptojë të kuptuarit se si funksionojnë veçoritë e vogla; për shembull, si është përdorur një rrjetë e vjetër peshkimi dhe nga çfarë është e përbërë. Sidoqoftë, interpretimi i trashëgimisë së vërtetë fillon aty ku këto karakteristika përfshijnë një kuptim më të thellë, ku përvoja prek një detaj të thellë - për shembull, sesi e gjithë jeta e familjes së peshkatarit ka qenë e lidhur me atë rrjetë të vetme. Puna me detaje si pjesë e mesazheve interpretuese (f. 18) është thelbësore për vlerën e interpretimit të trashëgimisë - por vlerat prekëse gjithashtu shtojnë përgjegjësinë e udhërrëfyesit interpretues. Rrjeti Ndërkombëtar i Kauzave të Përbashkëta ofron materiale të dobishme se si të përdoren vlerat dhe detajet në një mënyrë të përgjegjshme.

Interpretimi i ndjeshëm

Kjo është pika e fundit teorike përpara se të fillojmë të tregojmë anët më tërheqëse të profesionit tonë. Të vendosësh, me vetëdije, se çfarë është trashëgimia, është një proces intelektual; por siç mund ta shohim, trashëgimia dhe interpretimi i trashëgimisë ngjallin shumë emocione. Vendet e trashëgimisë variojnë nga vende tërheqëse, të tilla si një luginë piktoreske e lumit, tek vendeve ku ka pasur një ndikim në kulturën e vet, si një kishë e ndërtuar në themelet e një xhamie të vjetër – apo vendet që mbartin tragjedi me vete, të tilla si një peizazh që duket se është shkatërruar përgjithmonë ose mbetjet e një kampi përqendrimi. Është një tregues i mendjeve të hapura nëse vendet apo objektet e diskutueshme mbrohen si trashëgimi. Dhe megjithëse disa nga këto vende mund të na paraqesin një sfidë të madhe neve si udhërrëfyes interpretues, ato theksojnë rolin kyç që interpretimi i trashëgimisë mund të luajë në drejtim të të mësuarit nga e kaluara për të ardhmen.

 Qendra Kërkimore me Interes
PUBlik
Manuali i Kauzës së Përbashkët
Machynlleth (2011)
Download falas në:
www.valuesandframes.org

Aspekti personal

Personaliteti ynë ka një farë rëndësie në udhërrëfimin interpretues - veçanërisht për udhërrëfyesit, të cilët me kalimin e kohës janë rritur në zonën ku punojnë dhe jeta e të cilëve është e ndërthurur me mjedisin e tyre natyror ose kulturor. Përvojat dhe kujtimet personale shpesh janë më interesante sesa informacioni faktik për pjesëmarrësit. Përshtypja personale që ne si udhërrëfyes transmetojmë tek pjesëmarrësit tanë, kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në suksesin e një bisede ose shëtitjeje interpretuese.

Frymëzim më mirë sesa udhëzim

Si udhërrëfyes interpretues, detyra jonë nuk është të jemi instruktorë ose të deklarojmë fakt pas fakti. Në fakt, ne jemi lehtësues, duke dhënë shpjegime, duke u ofruar pjesëmarrësve tanë perspektiva të reja, duke qenë të gatshëm për të shkëmbyer përvoja dhe për t'i nxitur ata të zbulojnë më shumë për veten e tyre. Kjo përfshin vënien në pikëpyetje të perspektivave tona, nga njëra anë për të nxitur pjesëmarrësit tanë të mendojnë - dhe nga ana tjetër gjithashtu për të mësuar më shumë për veten tonë. Si udhërrëfyes interpretues, ne jemi gjithashtu nxënës.

Të genurit familjar me role të ndryshme

Për të krijuar një atmosferë të këndshme për të mësuar, ne duhet të jemi në gjendje të luajmë role të ndryshme. Udhërrëfyesit interpretues argumentojnë, dëgjojnë dhe ndërmjetësojnë, ata shpjegojnë, frymëzojnë dhe nxisin, mund të shkaktojnë tension ose të ofrojnë momente për relaksim dhe ata gjithmonë mbështesin pjesëmarrësit e tyre në habitjen e tyre ndaj zbulimeve të reja. Si udhërrëfyes interpretues, ne krijojmë një pjesë të vogël teatrale, një dramë të paharrueshme që përforcon mesazhet dhe kujtimet.

Njerëzit nuk e ndryshojnë jetën e tyre bazuar në të dhëna. Ata e ndryshojnë atë bazuar në një përvojë, një kontakt intim që ata kanë me dikë që i besojnë.

Alan AtKisson

Ushtrim: Të luajmë role të ndryshme

Le të shkruajmë një temë në secilën prej rreth 10 kartave të lehtësimit; temat mund të jenë 'udhëtim', 'dritë', 'zhurmë', 'mërz', 'fillim' etj. Pastaj përgatitim disa kapele letre duke shkruar nga një rol në secilën, për shembull, 'mësues', 'ndërmjetës', 'tregimtar', 'avokat', 'animator' etj. Njëri prej nesh vizaton një kartë teme, zgjedh një kapelë roli dhe prezanton temën duke përfshirë të tjerët në rolin që lidhet me atë kapelë. Pas pak, dikush tjetër merr një kapelë tjetër, duke luajtur një rol të ri derisa të përdoren të gjitha kapelet.

Një tjetër version i këtij ushtrimi është vendosja e kapelave në 'ishuj' të vetëm të shënuar me spango të shtrenguar me lak. Kjo jep mundësinë për të kërcyer nga një ishull në tjetrin gjatë prezantimit të temave.

Më në fund ushtrimi mund të bëhet duke ndarë pjesëmarrësit në grupe me dy ose tre persona. Një grup merr një kapelë roli (ose thjesht një kartë roli) pa i lënë të tjerët të dinë se çfarë roli përfaqëson grupi. Grupi më pas kërkon një objekt dhe pas pak fillon ta prezantojë atë objekt sipas rolit të tij (por pa kapelë) ndërsa të tjerët mendojnë se çfarë roli luan grupi.



Tejkalimi i dobësive

Një shenjë dalluese e suksesit, një nevojë për çdo punë të suksesshme, është të jesh i vetëdijshëm për dobësitë e tua, të merresh hapur me to, por edhe t'i konsiderosh ato si sfida për të mësuar. Kjo vlen edhe për udhërrëfyesit interpretues. Në çdo shëtitje interpretuese, ne duhet të mundohemi të arrijmë një objektiv të vetëm - dhe të bëjmë një vetë-vlerësim, menjëherë pas shëtitjes, se sa mirë e kemi arritur këtë objektiv.

Interpretuesit i kthejnë fenomenet në eksperiencë



*Mos u mundoni të kënaqni
krenarinë tuaj
duke mësuar shumë gjëra.
Zgjeni kureshtjen e njerëzve.
Mjafton të hapësh mendjen;
mos i mbingarkoni ato.*

*Nxisni atje vetëm një shkëndijë.
Nëse ekziston ndonjë send
me vlerë për t'u ndezur,
ai do të marrë flakë.*

Anatole France

Të ndihmojmë objektet dhe fenomenet të marrin jetë

Në thelb të çdo aktiviteti interpretues janë përvojat e këndshme të drejtpërdrejta, me elemente autentike të trashëgimisë. Për të theksuar vlerën e tyre, ne i quajmë këto elemente fenomene. Ne mund t'i perceptojmë të gjitha fenomenet me shqisat tona nëse ato janë objekte të prekshme siç janë pemët, pikturat ose shtëpitë apo ndjesi të paprekshme siç janë vallëzimet, këngët ose lindja e diellit. Si udhërrëfyes interpretues, ne përpiqemi të paraqesim tema vetëm atje ku dhe kur ato mund të shihen ose perceptohen, dhe ne i tregojmë ato si diçka individuale. Për shembull, ne nuk merremi me kishat gotike në një mënyrë të përgjithshme duke parë një prej tyre si një përfaqësuese të vetme të një periudhe arkitekture, ne gjithmonë merremi me shembullin e veçantë që mund të shohim, me historinë e saj specifike dhe cilësitë specifike.

Për këtë arsye, interpretimi i një fenomeni, për shembull, në një rezervat natyror do të jetë i ndryshëm në pranverë dhe në vjeshtë, dhe do të jetë i ndryshëm nën rrezet e diellit dhe në shi. Përjetimi i një vendi ose objekti drejtpërdrejt është pjesa me më shumë vlerë në paketën e çdo aktiviteti interpretues. Edhe një artefakt i dëmtuar i cili gjendet rastësisht gjatë një shëtitje interpretuese është zakonisht një përvojë më e fuqishme sesa një homolog apo imazh i përsosur në xhepin tuaj. Sa më shumë që një udhërrëfyes të jetë familjar me momentet kur has sende ose vende të papritura (por me përvojë ndoshta të parashikueshme), aq më i mirë do të jetë ai / ajo.



Ushtrim: Të theksojmë veçantinë e një fenomeni

Le të ndahemi në katër grupe, secili i afrohet një prej katër fenomeneve që duken shumë të njëjta në shikim të parë, për shembull, katër pemë buzë rrugës me vjetërsi dhe zhvillim të ngjashme. Secili grup heton karakteristikat e fenomenit të tij të zgjedhur në krahasim me të tjerët. Në fund, secili grup prezanton fenomenin e tij, duke shprehur qartë 'personalitetin' e tij.

Ngazëllimet e fshehta

Një rrufe ndan në mes një pemë pishë dhe një kërpudhë përhapet përgjatë çarjes në njërën anë. Grupi, i drejtuar nga ana tjetër e pemës, nuk mund të shohë ndonjë gjë të veçantë në lidhje me të. Sidoqoftë, ata së shpejti zbulojnë tingujt ose aromat e zonës së dëmtuar. Ato e bëjnë një shëtitje interpretuese tërheqëse.



Ushtrim: Të zbulojmë sekretet

Në një vend të trashëgimisë, për shembull, në një muze të hapur, secili prej nesh kërkon fenomene që përfshijnë 'sekrete'. Pastaj, njëri prej nesh i udhëzon të tjerët drejt një fenomeni të tillë, duke krijuar pritshmëri dhe duke zbuluar papritmas tiparin e fshehur sa më dramatikisht të jetë e mundur.

Përzgjedhja nga një larmi hapash strategjike

Me trekëndëshin e interpretimit në mendje, ne flasim në mënyrë figurative për hapat që duhet të ndërmarrim kur bëhet fjalë për elemente komunikuese që ndihmojnë për t'u dhënë pjesëmarrësve tanë qasje në fenomene. Çdo shpjegim mund të jetë një hap i tillë, dhe në një udhëtim në terren ose një vizitë në muze me cicironë, shpjegimet mund të jenë të mjaftueshme. Por, për një aktivitet që synon një audiencë të gjerë, shpjegimet e hollësishme në përgjithësi nuk janë të përshtatshme. Për këtë arsye, udhërrëfyesit interpretues pajisen me një larmi të gjerë metodash, ku secili i përshtatet grupit, si dhe fenomenit.

Mënyrat për të treguar historinë tënde: hapat metodikë drejt fenomeneve

- ⇒ shpjegimi
- ⇒ përshkrimi (vëzhgimi)
- ⇒ tregim (histori aventurë, përrallë, legjendë, shaka)
- ⇒ shprehje në një art interpretues (poezi, rimë, këngë, ritëm)
- ⇒ stimulimi i sensorëve të perceptimit
- ⇒ imagjinatë ngazëlluese (për shembull, nga forma të gurëve ose pemëve)
- ⇒ demonstrim
- ⇒ ilustrim (foto, vizatim, statistika)
- ⇒ hetim (eksperiment)
- ⇒ lojë (lojë me role)



Në këtë pikë, bëhet e qartë se hapat e ndryshëm u pëlqejnë disa pjesëmarrësve më shumë se sa të tjerëve. Ky faktor i rëndësishëm, të cilin do ta shtjellojmë më vonë, gjithashtu ndikohet nga zgjedhja e fjalëve.

Vendosja e fenomeneve në botën e pjesëmarrësve tanë

Mënyrat e angazhimit të audiencës suaj: hapa retorikë për fenomenet

krahasimi	Kjo qeramikë është aq e hollë sa pergamena
shembulli	Në këtë rrugë, qelqi ishte një nga mallrat e transportuara
piktura me fjalë	Këto vazo antike kanë veshë të mëdhenj.
zhvendosja e perspektivës	Nëse ne do të ishim punonjësit e qymyrit...
jetësimi	... dhe pastaj brumbulli i lëvores mendon...
kontrasti	Disa punonin në shtëpi, të tjerët kalonin gjithë ditën në këtë fabrikë.
kontradikta e dukshme	Druri i ngordhur është i gjallë!
citimi	Varfëria është prindi i krimit, siç eka thënë Aristoteli.



Ushtrim: Ti afrohem një fenomeni nëpërmjet hapave strategjikë

Le të shkruajmë hapat e renditur në dy kutitë e mësipërme në disa karta lehtësuese, kërkojmë një objekt tërheqës të trashëgimisë dhe vendosim kartat midis nesh dhe këtij objekti. Pas një momenti, të gjithë zgjedhin një letër dhe, kur të jenë marrë të gjitha kartat, secili shpjegon me rradhë shembullin e një strategjie që ai / ajo zgjodhi; për shembull, pamja që duhet të interpretohet janë disa kanale/vija në një gur, ⇒ (citati) ⇒ rrjedhja e vazhdueshme lë shenja mbi gur (Choerilus i Samos).

Teksa shohim të gjithë tablonë

Përjetimi i objekteve ose i vendeve origjinale si diçka unike nuk nënkupton të mos i vendosësh ato në një kontekst më të gjerë. Ndonjëherë edhe referencat botërore kanë kuptim (fq. 20-21). Dhe përdorimi i tyre si një shembull kujdesi ndaj trashëgimisë sonë është i pranueshëm për sa kohë që interpretimi qëndron i përqendruar në fenomen.

Biseda dhe shëtitje

Kur zbulojmë disa nga sekretet e një fenomeni, duke qëndruar në të njëjtin vend për pesë deri në dhjetë minuta, p.sh. në hyrje të një kështjelle të vjetër, ne e quajmë këtë një bisedë interpretuese. Bisedat interpretuese janë thelbi i udhëzimit. Ekspozitat me pjesëmarrës të konsiderueshëm dhe vendet e njohura ku vizitorë të rinj vijnë vazhdimisht, ofrojnë mundësi të mira për tu njohur me këtë qasje; p.sh. duke mbajtur një fjalim të ngjashëm interpretues në të njëjtin vend në çdo orë. Shtigjet interpretuese përbëhen nga disa biseda interpretuese. Të gjitha qasjet ndaj interpretimit personal nuk duhet të jenë kurrë monolog; ato gjithmonë duhet të përfshijnë pjesëmarrësit.



Interpretuesit nxisin ndjesi tek pjesëmarrësit



*Për sa kohë që unë jam duke folur,
Unë nuk do të përfetoj asgjë të re.*
Marie von Ebner-Eschenbach

Të qenit i vetëdijshtë për avantazhet e udhërrëfimit

Parimi i parë i interpretimit thotë se ne duhet t'i lidhim fenomenet me personalitetin e pjesëmarrësve. Prandaj është e nevojshme të dini diçka rreth tyre, prejardhjen dhe përvojat e tyre. Të jesh në gjendje ta zbulosh këtë dhe t'a përdorësh është një nga përparësitë e mëdha që një udhërrëfyes ka krahasuar me një panel interpretimi ose një instalacion multimedial.

Të shkojmë afër pjesëmarrësve

Për të nxitur ndjesi dhe për të arritur nivelin e dialogut, së pari duhet të 'jemi në kontakt' me pjesëmarrësit. Duke kujtuar trekëndëshin e interpretimit, ne mund të përdorim hapat strategjikë - por tani po flasim për hapat që duhet të hedhim ndërmjet udhërrëfyesve dhe pjesëmarrësve.

Mënyrat për të krijuar lidhje me njëri-tjetrin: gurët ku duhet të shkelim për të shkuar nga udhërrëfyesi tek pjesëmarrësit

- ⇒ kuptueshmëria (gjuha dhe përmbajtja)
- ⇒ kontakt me sy (gjithashtu duke shqyrtuar reagimet)
- ⇒ qëndrimi përballë pjesëmarrësve dhe përdorimi i gjuhës së përshtatshme të trupit
- ⇒ humori (duke treguar kujdes!)
- ⇒ të qenit mendjehapur (për shembull, gatishmëria për të devijuar nga idetë personale)
- ⇒ prezantimi i njëri-tjetrit dhe përdorimi i emrave të pjesëmarrësve
- ⇒ të dëgjojmë për të mësuar më shumë (Pra – ju vini shpesh këtu?)
- ⇒ të vëzhgojmë dhe të gjëjmë interesa dhe pikëpamje të ngjashme
- ⇒ duke iu referuar miqve ose grupeve të lidhura me pjesëmarrësit
- ⇒ duke iu referuar botës së vetë pjesëmarrësve (puna, familja, hobi etj).

Udhërrëfyesit interpretues kanë një ndikim përmes asaj që thonë dhe mënyrës si e thonë. Udhërrëfimi ka të bëjë me komunikimin dhe të folurit në publik. Të dy mund të trajnohen nëpërmjet kurseve të përgjithshme të të folurit publik në disa vende, për shembull, në një universitet. Dy ushtrimet e mëposhtme vlejné si shembuj.



Ushtrim: Të shprehim humoren e gjithësecilit

Le të marrim një fjali neutrale (për shembull: Në vjeshtë, shumë zogj shkojnë drejt jugut) dhe përgatisim letra të vogla, secila me një mbiemër që përshkruan një gjendje shpirtërore (për shembull, të dëshpëruar, të ndrojtur, arrogant). Pastaj, secili pjesëmarrës tërheq një letër dhe e thotë të njëjtën deklaratë duke shprehur gjendjen përkatëse, ndërsa të gjithë të tjerët përpiqen të zbulojnë se cila ndjesi/humor nënkuptohet.

Ushtrim: Të përshkruajmë një skenë pa përdorur fjalë

Le të zhvillojmë një histori të thjeshtë (për shembull, duke ecur nëpër një peizazh) me veprime (për shembull, duke paketuar një çantë shpine ose duke kërkuar udhëzime) dhe të shkruajmë skenën në karta me numra. Të gjithë pjesëmarrësit do të marrin një nga këto karta. Me radhë, ata paraqesin skenën e tyre sipas gjuhës së trupit; nuk lejohen tinguj. Në fund, historia rikrijohet dhe grupi diskuton se cila skenë ishte shprehur më mirë dhe si.

Të nisim një bisedë

Tani i kushtojmë pak vëmendje mënyrës se si një prezantim mund të bëhet më tërheqës. Sidoqoftë, Asi në paketën e treguar në këtë faqe ka dy shigjeta, që simbolizon bisedën. Udhërrëfyesi duhet të kalojë shpejt nga 'dhënia e një leksioni' në një shkëmbim të vërtetë me pjesëmarrësit. Një grup që vendoset vetëm në rolin marrës është vështirë ta 'kthesh mbrapsht në jetë'.

Të bëhemi pjesë e botës së pjesëmarrësve tanë

Një shkëmbim mund të rezultojë nga përvojat e zakonshme që ngrenë çështje ose nga pyetjet që mund të bëjë udhërrëfyesi. Pyetjet e hapura janë veçanërisht të dobishme. Pyetjet e hapura janë ato që nxisin përgjigje të ndryshme në varësi të përvojës së vetë pjesëmarrësve, sesa vetëm po ose jo, për shembull, "Nga cilat rajone të tjera të Evropës ju kujton kjo peizazh?" Përgjigjet e ndryshme shpesh japin mundësi të mira për një bisedë.



Ushtrim: Të bëjmë pyetje të hapura

Le të ndahemi në grupe, secili duke zgjedhur një fenomen dhe duke u përgatitur për të adresuar këtë fenomen:

- ⇒ një pyetje me fokus (përgjigja kërkon kontakt të drejtpërdrejtë me fenomenin); p.sh. "Si tingëllon qeramika e kësaj tenxhere nëse e prekni?"
- ⇒ një pyetje transferuese (e cila kërkon lidhje me botën e pjesëmarrësve); p.sh. "Ku keni parë qeramikë të tillë më parë?"
- ⇒ një pyetje procesuese (e cila kërkon të mësojë si diçka mund të ndodhë); p.sh. "Në cilat kushte tenxhere të tilla mund të durojnë për një kohë të gjatë?"
- ⇒ një pyetje vlerësuese (e cila ka nevojë të nxjerrë një mendim); p.sh. "A duhet të gërmohen qeramikat e vjetra, apo duhet të qëndrojnë atje ku janë?"

Pas kësaj, një person nga secili grup fillon një dialog me të gjithë, duke përfshirë në fshehtësi katër pyetjet. Pasi të jetë bërë kjo, ne krahasojmë atë që zbuluam.



Pyetjet e mbyllura kanë vetëm një përgjigje të paracaktuar (për shembull, "Si është emri i këtij stili arkitektonik? A e di dikush?"). Megjithatë përgjigjet mund të përdoren për të dhënë shpjegime, pyetje të tilla duhet të bëhen rrallë sepse ato priren të rezultojnë në ndarje informacioni në mënyrë formale.

Të përfshijmë njeriun si i tërë

Udhërrëfimet interpretuese i drejtohen gjithmonë kokës, zemrës dhe duarve. Ajo për të cilën njerëzit kanë ndjeshmëri dhe çfarë thonë dhe bëjnë vetë, i ndihmon ata të përvetësojnë përvojën më shumë sesa kur thjesht dëgjojnë ose shohin.


Faza e parë e aktivizimit mund të jetë një demonstrim ku përfshihen pjesëmarrës individualë ("A mund ta kapni këtë degë?"). Të jesh i nevojshëm për të tjerët është diçka tërheqëse për shumicën e njerëzve. Një nxitje tjetër është të kërkon për diçka, për shembull, një bimë të rrezikuar ose një element të stilit arkitektonik.

Faza e dytë, pjesëmarrja e vërtetë, do të thotë të shkojmë një hap më tej. Ajo siguron mundësinë për të përcaktuar ecurinë e një aktiviteti. Ky nocion i pjesëmarrjes, i cili luan një rol shumë të rëndësishëm në mësimin bashkëkohor, është theksuar si thelbësor për interpretimin e trashëgimisë për më shumë se 50 vjet. Nëse njerëzit marrin pjesë, ata janë më shumë të përfshirë. Për shembull: vizitorët në rrënojat e një vile romake tregojnë interesin e tyre për një aspekt të veçantë të jetës së një familjeje, dhe udhërrëfyesi menjëherë i njeh me mjediset që lidhen me të.

Pjesëmarrja nxit ndjeshmëri. Sidoqoftë, një sfidë e pjesëmarrjes mund të jetë fakti se rrjedha e një aktiviteti interpretues nuk mund të parashikohet në detaje. Në faqet vijuese ne do të shpjegojmë se si të menaxhojmë këtë pasiguri

*Vetëm me zemër mund të shihet
në mënyrë të drejtë, ajo ç'ka është
thelbësore, është e padukshme
për syrin
Antoine de Saint-Exupéry*

Interpretuesit ofrojnë rrugë drejt të kuptuarit më të thellë



Faktet shkencore kanë nevojë për histori të lezetshme për të fituar afeksionin e njerëzve. Në këtë rast, miti nuk është aty për të garuar me të vërtetën por për të bërë lidhje me atë që ka rëndësi për njerëzit dhe çfarë i bën ata të ëndërrojnë.

Denis Guedj

Mesazhi

- ⇒ është një fjali e shkurtër
- ⇒ të futet në lëkurë
- ⇒ ndjek një ide të vetme
- ⇒ godet në një pikë
- ⇒ mund të përjetohet në atë vend
- ⇒ lidhet me botën e pjesëmarrësve
- ⇒ shërben si far ndriçues

Mesazhi interpretuese

Nëse shikojmë interpretues me përvojë teksa bëjnë punën e tyre, na bën përshtypje lehtësia dhe konciziteti i bisedave dhe shëtitjeve të tyre interpretuese. Sekretet qëndron në aftësinë e përmbledhjes së historive të gjata në mesazhe bindëse. Mesazhet janë një nga elementët më të rëndësishëm të interpretimit. Ato lidhin tre gurët e themelit të trekëndëshit interpretues, zgjojnë imazhe të brendshme dhe i japin ngjarjes një drejtim të qartë në një mënyrë stimuluese. Por, ato përmbysin edhe disa procese të arsimit tradicional.

Duke kërkuar për deklarata të mesazheve kuptimplotë

Kur përgatemi për një shëtitje, disa udhërrëfyes priren të përqendrohen në tema dhe fakte. Në interpretim, ky fokus është zhvendosur në mesazhe dhe kuptime. Kjo nuk do të thotë që faktet nuk janë të rëndësishme - ato janë. Por ato janë të organizuara në një mënyrë tjetër - rreth një mesazhi. Në këtë mënyrë ato mund të mbahen mend shumë më mirë. Një mesazh përfaqëson një kuptim më të thellë që lidhet me natyrën e fenomenit si dhe me formimin dhe përvojën e pjesëmarrësve.

Shembuj për deklarata të mesazheve

- ⇒ Kjo farë e vogël përmban një pemë të madhe. (Fara e pishës)
- ⇒ Gruaja e fermerit nuk e vendosi kurrë këtë fustan në gardërobë. (Fustan i leckosur)
- ⇒ Kjo shportë kishte nevojë për pak material - por shumë punë. (Shporta e vjetër prej leshi)
- ⇒ Këtu jemi duke qëndruar në fund të një deti antik. (Pllakë guri ranore)
- ⇒ Kjo tokë e shkretë e bën mbijetesën të jetë një sfidë. (tokë djerrë)

Mesazhet janë histori me një fjali që mund të nxisin ndjeshmëri në përvojat e pjesëmarrësve tanë. Ashtu si në shembujt e mësipërm, ato lidhen drejtpërdrejt me fenomenet (nëse nuk formojnë bazën e një ecjeje interpretuese si mesazh kryesore; shih fq. 22).

Si funksionojnë mesazhet

Le të marrim si shembull farën e vogël - e cila përmban atë që një ditë do të jetë një pemë e madhe. Një pemë është një fenomen: ne mund ta shohim, dëgjojmë, prekim, nuhasim ose shijojmë atë. Ajo që nuk mund të përjetojmë është procesi i rritjes; supozojmë se ky është një fakt. Sidoqoftë, të dish se një pemë mund të rritet nuk na prek shumë thellë. Por sapo të kuptojmë se diçka kaq e vogël që nuk bie në sy, bëhet diçka mbresëlënëse, kjo mund të ketë një kuptim më të thellë për ne. Ne jemi familjarë me këtë model nga vetë jeta jonë, dhe ai shkakton emocione dhe vlera - në këtë rast mbase admirim dhe idenë e vetë-zhvillimit. Si rezultat, ajo farë e thjeshtë papritmas bëhet domethënëse për ne dhe ne ndihemi të lidhur me të.

Fenomeni	Fakti	Kuptimi
Kjo farë e pishës	do të rritet	nga diçka kaq e vogël që nuk bie në sy, në diçka mbresëlënëse.



Ushtrim: Të diferencojmë faktet nga kuptimet

Le të shpërndahemi në një zonë, secili prej nesh duke kërkuar një objekt të vogël i cili ngjall disa reagime tek ne. Ne mbledhim objektet tona në një copë pëlhure dhe i shikojmë, duke marrë parasysh pyetjen: "Çfarë është ajo?" Pastaj njëri pas tjetrit e kalon objektin e tij / sau përreth, duke ia shpjeguar vetes kuptimin e tij (për shembull, një pendë e shtypur nga një zog që ngjall dhembshuri). Së bashku ne tregojmë ndryshimin midis faktit ("Çfarë është ai?") dhe kuptimit ("Çfarë më ngjall mua?").

Të zbulojmë universalen

Kuptimet janë individuale, por disa prej tyre janë pjesë e pothuajse të gjithë njerëzve. Këto quhen koncepte universale - si lindja dhe vdekja, ose si liria dhe robëria. Mesazhet, përfshirë detajet e thella (fq. 12), që janë universale funksionojnë pothuajse gjithmonë. Ato shkaktojnë diçka tek të gjithë, edhe në rast se mund të mos jetë i njëjti kuptim për secilin person. Por mesazhet universale janë disi të ndryshueshme dhe prandaj prirjen të jenë sipërfaqësore, nëse përdorim të njëjtat mesazhe shumë shpesh dhe nëse nuk sigurohemi që domethënia e tyre, kuptimi i tyre specifik për vendin ose objektin origjinal, është i qartë.

Ti japësh gjallëri diçkaje të pajetë

Për shumë nga pjesëmarrësit tanë, bimët (veçanërisht bimët me lule) janë më tërheqëse se gurët, dhe kafshët (veçanërisht të vegjël) janë më tërheqëse sesa bimët - ndërsa njerëzit (veçanërisht fëmijët) janë më tërheqës për shumicën prej nesh. Fenomenet më pak tërheqëse marrin më shumë vëmendje nëse lidhen me diçka më tërheqëse. Për shembull, një tenxhere qeramike ka shanse të bëhet shumë më interesante nëse ekziston një histori emocionuese për mënyrën se si është zbuluar ose çfarë përfaqëson tenxherja në një kulturë antike.

Ushtrim: Të lidhim objektet me historitë

Në një çantë, mbledhim po aq objekte të përditshmërisë, sa numri i anëtarëve të grupit tonë. Ulemi në një rreth, dhe dikush merr çantën. Ai / ajo nxjerr një nga objektet rastësisht, duke treguar një histori që e bën atë tërheqëse për grupin. Në këtë mënyrë, çanta kalohet nga njëri tek tjetri. Nëse dikush nuk mund të tregojë një histori, ai / ajo e vendos objektin në qendër dhe merr një tjetër. Objektet në qendër do të prezantohen të fundit. Vëmendje: Në interpretim, ne kurrë nuk shpikim histori që nuk mbështeten nga fakte, porveç rasteve kur e theksojmë qartë atë.

Ti konsiderojmë mesazhet si një far



Mesazhi nuk na mbështet vetëm duke lehtësuar marrëdhëniet midis pjesëmarrësve tanë dhe fenomeneve tona, por është gjithashtu një mjet organizimi. Ashtu si një far që drejton rrugën e një anijeje, mesazhi është elementi i vetëm që nuk duhet të ndryshojë gjatë një bisede interpretuese. Kjo i lejon pjesëmarrësit të përfytyrojnë fenomenin, duke ua shprehur kuptimin pa rrezikun e humbjes së fokusit. Përdorimi i metaforës së farit përsëri: Për shkak të erërave dhe rrymave, ne rrallë i afrohem një fari në një vijë të drejtpërdrejtë, por ne gjithmonë e mbajmë atë në shikimin tonë.

Ushtrim: Kuptimet në pak fjalë

Në mjedisin që na rrethon, secili prej nesh kërkon një fenomen që i bën përshtypje veçanërisht atij / asaj dhe na duhen rreth dhjetë minuta për ta vizatuar atë në një kartë. Pas kësaj, dy pjesëmarrës bashkohen, shkëmbejnë kartat e tyre, vizitojnë njëri-tjetrin në fenomenet e tyre dhe përshkruajnë se çfarë u bëri përshtypje. Pastaj ata ndahen për dhjetë minuta të tjera, duke u ulur dhe përmbledhur ato që kanë dëgjuar, në një fjalë të vetme të shkurtër, të shpejtë dhe shprehëse. Pas kësaj, të gjithë takohen përsëri, duke udhëhequr njëri-tjetrin nga fenomeni në fenomen pa folur, thjesht duke thënë këto fjalë të vetme. Më në fund ne do të mendojmë se cila fjalë mund të përdoret më mirë si mesazh për një bisedë interpretuese.

Ushtrim: Të zbulojmë mesazhet nëpërmjet vetes

Të gjithë ne përballemi me një fenomen dhe mendojmë se çfarë mund të na tregojë për veten. Ne i shkruajmë këto mesazhe të vetes (për shembull, nga një shkëmb i madh: "Një akullnajë më solli këtu") në copa letre dhe i vendosim në vendin e duhur përreth fenomenit. Më pas ne shqyrtojmë se cili nga mesazhet e vetvetes mund të shndërrohet në mënyrë më të përshtatshme në një mesazh më të gjerë, cila histori tërheqëse mund të tregohet me atë mjet dhe cilat fakte mund ta mbështesin atë histori.



Ndryshimi i formacioneve

Formacioni i trekëndëshit në vend

Në interpretim, rregullimi i grupit në vendet dhe objektet autentike quhet 'formim' dhe ka disa formacione të tilla. Parimi më i rëndësishëm është: Interpretuesi nuk duhet të qëndrojë midis fenomenit dhe pjesëmarrësve - përveç nëse ai / ajo fsheh qëllimisht fenomenin në mënyrë që ta zbulojë atë më vonë. Në shumicën e rasteve, është më mirë nëse fenomeni, interpretuesi dhe pjesëmarrësit formojnë fizikisht trekëndëshin e interpretimit, i cili shpjegohet në faqen 9.

Ofrimi i një formacioni të përshtatshëm për grupin

Pjesëmarrësve u duhet kohë dhe hapësirë për të arritur në fenomenin përkatës dhe për të gjetur vendin e tyre. Në shëtitje, interpretuesi zakonisht ecën disa hapa përpara, pret derisa grupi të zërë pozicionin e tij dhe pastaj kërkon vendndodhjen më të mirë për veten. Ky është një proces që grupi zakonisht nuk e vë re. Vetëm rrallë - nëse grupi është në rrezik ose nëse formacioni nuk është arritur, megjithëse është shumë i rëndësishëm për interpretimin - interpretuesi duhet t'i drejtojë pjesëmarrësit e tij / saj, për shembull, të zbrapsen, të rreshtohen ose të formojnë një rreth. Një formacion i përshtatshëm është një kriter i rëndësishëm për zgjedhjen e një fenomeni.

Përdorimi i formacioneve të ndryshme

Të gjithë formacionet kanë avantazhe dhe disavantazhe. Formacioni linear (Fig. 1) ka shumë disavantazhe, por mund të jetë i pashmangshëm - për shembull në një shteg që kalon një kodër me një pamje mahnitëse, në një ballkon që ka pamje mbi një qytet, në një bankinë nga e cila mund të shihen gaforret në sipërfaqen e ujit, ose në rrëzë të një shkëmbi ku mund të vërehen fosilet në një mur shkëmbi. Nëse është e mundur, në raste të tilla grupi duhet të informohet paraprakisht në një vend më të përshtatshëm.


Asnjë formacion nuk duhet të mbizotërojë një ecje interpretuese. Megjithatë, i ashtuquajti formacioni didaktik (Fig. 2) shpesh e bën këtë gjë. Në këtë rast, grupi është i përqendruar tek interpretuesi, thjesht nga fakti që interpretuesi po flet. Nëse ai / ajo shkon përkrah fenomenit të qartë, grupi do të formojë vetë këndin e tretë të trekëndëshit.

Një mënyrë për të ndryshuar fokusin nga interpretuesi tek anëtarët e tjerë të grupit është përdorimi i formacionit të konferencës (Fig. 3). Kjo vjen si rezultat i një bisede në të cilën fenomeni është pjesë, ose nëse është e mundur, kur ai është fokusi. Ky formacion do të vijë si rezultat i sjelljes së një objekti të vogël, për shembull, një maje shigjete prehistorike, në pjesën e përparme.

Nëse interpretuesi po tërhiqet nga rrethi, duke lehtësuar një bisedë nga mbrapa, formacioni i udhëzuesit (Fig. 4) do të jetë rezultati.

Më në fund, është e mundur të ndahet grupi duke u dhënë pjesëmarrësve detyra të ndryshme (për shembull, kërkimin ose monitorimin), duke u kërkuar atyre të raportojnë më pas: formacionin individual të detyrave (Fig. 5).

Formacionet ndikohen nga hapësira në dispozicion dhe nga situata në vend (rrjedha, pastrimi etj.). Sa më i madh grupi, aq më pak mundësi ka interpretuesi. Siç thamë, gjatë secilit fjalim, është mirë të ndryshohet formacioni të paktën një herë. Me ushtrimin Zbulimi i sekreteve (f. 14) kjo mund të arrihet.



Zgjedhja e mjeteve ndihmëse (lehtësuese) me vetëdije

Ka mënyra të shumta për të 'sjellë në vëmendje' objekte që nevojiten nga çantat e shpinës gjatë një shëtitje interpretuese. Kriteri më i rëndësishëm i përzgjedhjes është që ato të mbështesin fenomenin dhe mesazhin e tij - dhe jo vetëm të dalin në pah për audiencën.

Megjithatë duhet thënë se mjetet (sendet) lehtësuese mund të jenë më të besueshme se fenomeni, ky është një rrezik i vazhdueshëm. Për shembull, panelet e vendosura përpara vendeve ose objekteve mund të ofrojnë orientim (për shembull, nëse përmbajnë harta), por ato gjithashtu mund të heqin vëmendjen nga prezantimi i rastësishëm me vendet dhe fenomenet e tyre.

Sendet lehtësuese mund të krijojnë efekte të këndshme, por ato duhet të përdoren me kujdes. Jo gjithçka që vlen në rast emergjence duhet të prezantohet, dhe jo çdo efekt argëtues në grup mbështet vërtet fenomenin.

Përdorimi i mjeteve ndihmëse



Sendet lehtësuese

- ⇒ bëj diçka më të dukshme (për shembull, dylbi, lupë zmadhuese)
- ⇒ kuadro fushën e shikimit (për shembull, korniza të vogla fotografie)
- ⇒ fokusoni pamjen (për shembull, tuba për të parë nëpërmjet tyre)
- ⇒ mundësimi i perspektivave të reja (për shembull, pasqyra)
- ⇒ të miksojmë senset (për shembull, mbyllja e syve, kufje)
- ⇒ markimi ose lidhja (për shembull, flamuj, tela)
- ⇒ ofrimi i njohurive (për shembull, thikë për të prerë)
- ⇒ shpjegimi i tipareve (për shembull, grafikët e modeleve funksionale)
- ⇒ të bëhen proceset më të dukshme (për shembull, modele, imazhe historike)
- ⇒ të zgjerohen eksperiencat (për shembull, produkte si rrëshirë, uthull, miell)
- ⇒ stimulimi i imagjinatës (për shembull, bojëra uji në panele)

Interpretimi i drejtpërdrejtë si një formë e veçantë udhërrëfimi interpretativ

Në interpretimin e drejtpërdrejtë, rëndësi të veçantë kanë mjetet ndihmëse, me anë të kostumeve, të cilat përdoren shpesh në shëtitjet historike. Duke luajtur si personazhe të veshur me një kostum të një periudhe kohore të caktuar, pjesëmarrësit i shohin gjërat përmes syve të këtyre personazheve, zhyten në një epokë tjetër dhe krijojnë lidhje më të thella.

Ne mund ta dallojmë interpretimin e drejtpërdrejtë në vetën e parë (ku aktori është personazhi) nga ai në vetën e tretë, që është përshkrues dhe më i zakonshëm në një shëtitje interpretuese, ku interpretuesi ka veshur një kostum për efekt të interpretimit. Personazhi nuk është luajtur në të vërtetë, por thjesht shpjegohet me anë të përdorimit të sendeve lehtësuese.

Në interpretimin e drejtpërdrejtë - në vetën e parë - interpretuesi sillet vazhdimisht si karakteri në periudhën e saj / tij. Kjo do të thotë që ai / ajo duhet të ndërtojë atë karakter paraprakisht; ose duke studiuar biografite e një personi të njohur për të qenë personazh ose duke vendosur një karakter fiktiv nga ajo kohë; të mendosh se ku mund të ketë jetuar ky person, sa fëmijë mund të ketë pasur, cilat ishin shqetësimet e saj/tij kryesore, miqtë dhe armiqët etj. Për t'iu përgjigjur pyetjeve nga pjesëmarrësit nënkuptohet përfshirja e tyre në dramë dhe kërkon aftësi teatrale dhe improvizuese. Për këtë arsye, interpretimi i drejtpërdrejtë i vetës së parë shpesh përdoret vetëm shkurtimisht gjatë një shëtitje interpretuese tradicionale, për shembull, nëse një punëtor mesjetar i qymyrit po demonstroi punën e tij gjatë një shëtitje nëpër një muze të hapur.

Për të pasur perspektiva të ndryshme (dhe për shkak se e bën interpretimin e drejtpërdrejtë shumë më të lehtë), nganjëherë disa interpretues përfshihen në një ngjarje. Ata më pas hyjnë në skenë papritur, përfaqësojnë personazhe të ndryshëm dhe frymëzojnë dhe përfshijnë pjesëmarrësit përmes tyre dhe mesazheve të tyre.

Meqenëse interpretimi i drejtpërdrejtë ka më shumë kërkesa sesa një ecje e thjeshtë interpretuese, ai nuk përfshihet në kursin tonë të trajnimit bazë për udhërrëfimin interpretues.

Pranimi i ndërhyrjeve

Ndërhyrjet marrin përparësi.

Ruth Cohn

Konsiderimi i incidenteve si mundësi

Vëmendja e pjesëmarrësve në të shumtën e rasteve rritet kur ndodh diçka që padyshim nuk ishte planifikuar. Surpriza të tilla mbeten përgjithmonë në kujtesë dhe prandaj janë një mënyrë efektive e të mësuarit - nëse shfrytëzohen mundësitë. Pra, është e rëndësishme të kuptojmë ndërhyrjet si mundësi për përfshirje më të madhe. Sigurisht, kjo nuk do të thotë se nuk ka nevojë për planifikimin e një shëtitje interpretuese. Teksa pjesëmarrësit e vlerësojnë rastin kur një interpretues është në gjendje të përballojë incidentin, humori i tyre ndryshon shpejt nëse rezulton se këto incidente dalin nga mungesa e përgatitjes.

Përfshirja e të papriturës

Ndërhyrjet shpesh lindin nga fenomenet; ose diçka nuk është si zakonisht (për shembull, një objekt është hequr nga një ekspozitë), ose diçka shtohet (për shembull, një zog i rrallë shfaqet papritmas gjatë një shëtitje). Moti është gjithashtu gjithmonë i mirë për surpriza. Edhe këtu, mesazhet mund të zgjerojnë efektin e tyre: sfida është të ndërthurni ngjarjen e paparashikuar me mesazhin mbizotërues, i cili, me pak praktikë, mund të arrihet më shpesh sesa mendohet.

Sidoqoftë, është thelbësore të mbajmë mend se asi ynë i lojës është përvoja e menjëhershme e elementit të trashëgimisë. Nëse diçka është hequr prej vendit, udhërrëfyshi interpretues nuk duhet të flasë për të sikur të ishte aty, por të kujtojë mesazhin e tij / saj ose të interpretojë situatën e re ose të kalojë në një fenomen tjetër që mund të mbështetet nga ai mesazh.



Ushtrim: Përgjigje ndaj surprizave

Të gjithë përveç tre anëtarëve të grupit lëvizin në një vend ku ata nuk mund të dëgjojnë dhe të shohin të tjerët. Dy nga ata që mbeten fillojnë të luajnë me role duke përdorur fjalë dhe gjeje të përshtatshme për një skenë të zgjedhur (p.sh. prerja e një trangu peme me një sharrë të madhe). Personi i tretë vepron si regjisor i skenës, duke duartrokatur sa më shumë që skena të duket interesante. Në këtë moment aktorët 'ngrijnë'. Një anëtar tjetër i grupit hyn në skenë, duke zëvendësuar një lojtar, duke marrë saktësisht pozicionin e saj / tij teksa ky lojtar bëhet pjesë e audiencës. 'Regjisor' përplas duart përsëri dhe dyshja e re fillon të luajë. Rregulli më i rëndësishëm është që ai që bashkohet merr iniciativën, ndërsa ai që tashmë ishte atje reagon. Nëse lojtari i ri e kupton skenën në një mënyrë tjetër (p.sh. duke pompuar një gomë biçiklete në vend që të presë një pemë), shfaqja merr një rrjedhë tjetër. Kur të gjithë pjesëmarrësit të kenë marrë pjesë, ne rikujtojmë të gjitha skenat.

Të pranojmë ndërhyrjet nga grupi

Ndërhyrjet mund të rezultojnë nga debate me pjesëmarrës që kanë (ose pretendojnë të kenë) më shumë njohuri se interpretuesi ose që nuk pajtohen me atë që u tha. Teksa në përgjithësi duhet t'i ftojme pjesëmarrësit të kontribuojnë për arsyet e përmendura më lart, fillon të bëhet e vështirë nëse të njëjtët njerëz duhet të shtojnë ose të kundërshtojnë pothuajse gjithçka që themi. Një mënyrë për të menaxhuar këtë është duke u dhënë atyre pak hapësirë, duke i mirëpritur ata si partnerë, pa humbur rolin udhëzues. Nëse kjo nuk ndihmon, grupi mund të pyetet nëse ata dëshirojnë të futen më thellë në debat ose të vazhdojnë ecjen.

Trajtimi i konflikteve nuk është pjesë e kursit, por përsëri, në disa vende menaxhimi i konflikteve mësohet për shembull, në kolegjet komunitare dhe kjo mundësi duhet të shfrytëzohet nëse është e mundur.

Të njohim pengesat

Në përdorimin më të njohur të fjalës, interpretim do të thotë përkthimi i gjuhës së fenomenit, dërguesit, në gjuhën e dëgjuesit, marrësit. Kjo mund të komplikohet nga disa faktorë:

- ⇒ pengesa të brendshme:
sjelljet negative, mungesa e informacionit, limitime intelektuale
- ⇒ pengesa të jashtme:
pajisje lehtësuese të papërshtatshme ose që mungojnë
- ⇒ pengesa në komunikim:
probleme gjuhësore, keqkuptime

Sipas këtij kuptimi, ideja e kërkimit të aksesit pa pengesa midis pjesëmarrësve, fenomeneve dhe interpretuesve dhe kapërcimi i pengesave ekzistuese nuk është e kufizuar tek njerëzit që zakonisht përshkruhen si: me aftësi të kufizuara. Për shembull, shembulli më i qartë i aksesit të kufizuar ndahet nga njerëzit që përdorin karriget me rrota, si dhe nga njerëzit që shtynë karrocet. Në Evropën Qendrore, rreth 40% e të gjithë vizitorëve të vendeve të trashëgimisë janë të pamundur fizikisht në një mënyrë apo në një tjetër (për shembull, shikimi, dëgjimi, sfidat në këmbë), dhe me rritjen e moshës mesatare të shoqërisë sonë, ky numër po rritet. Në fshat, të moshuarit shpesh nuk mund të ecin aspak të qetë, sepse nuk ka stola ose tualet përveç se në vende me distanca të largëta. Njerëzit që janë shtetas të rinj në një vend mund të kenë vështirësi gjuhësore dhe kulturore. Megjithatë shumë njerëz janë dukshëm të dëmtuar nga shikimi, njerëzit me dëmtim të dëgjimit formojnë një grup edhe më të madh - dhe shpesh mbeten pa u vënë re.



Ushtrim: Të krijojmë eksperiencë me ndjesi të pazakonta

Le të ndahemi në dy grupe. Të dy grupet përgatisin një bisedë interpretuese për të njëjtin fenomen. Në një rast, pjesëmarrësit lidhin sytë që të mos shohin gjë; në rastin tjetër, vendosin kufje. Secili grup vepron nga ana e tij si një grup turistësh për tjetrin. Ky ushtrim funksionon më mirë nëse grupi i turistëve nuk e njeh fare fenomenin. Kjo do të ishte rasti më i mirë nëse anëtarët e këtij grupi janë vërtet të kufizuar. Shoqatat për njerëzit me aftësi të kufizuara janë partnerë të mirë dhe shpesh bashkëpunues në këtë çështje.



Mundësimi i aksesueshmërisë

Aksesueshmëria do të thotë që rrethanat i lejojnë të gjithë njerëzit të bëjnë gjëra pa ndihmë nga dikush tjetër (përveç shtyrjes së karriges me rrota ose udhëzimit minimal të një personi të verbër). Planifikimi i një ecje interpretuese të arritshme nga të gjithë mund të përfshijë sigurimin e mundësive për pushime të shkurtra dhe krijimin e një shtegu pa pengesa në vend që të ofrohet një rrugë e veçantë për personat me aftësi të kufizuara. E njëjta gjë vlen për pjesëmarrësit me dëgjim me probleme (për shembull, duke folur ngadalë dhe qartë) ose me probleme shikimi (për shembull, duke i kushtuar vëmendje distancës dhe kontrastit). Është tepër e dobishme të përshkruani shumë, të kërkonit reagime dhe të nxisni përdorimin e të paktën dy shqisave kur planifikoni ndonjë aktivitet (për shembull, shikimi dhe prekja e një artefakti).

Duhet të jetë synimi i çdo interpretuesi për të siguruar shkëmbime të shpeshta me njerëz me aftësi të kufizuara në mënyrë që ai / ajo të mund të merret me ta si me të gjithë të tjerët.

Zgjerimi i horizontit

*Sfida jonë më e madh
në këtë shekull të ri
është të marrësh një ide
që duket abstrakte
- zhvillimi i qëndrueshëm -
dhe ta kthesh atë në një
realitet
për të gjithë njerëzit e botës.*

Kofi Annan



German Advisory Council
on Global Change (WBGU)
**World in Transition:
The Research Challenge**
Berlin (1996)

Shkarkohet falas tek linku:
www.wbgu.de

Të kuptojmë qëndrueshmërinë

Që kur Samiti i Tokës i Kombeve të Bashkuara u zhvillua në 1992 në Rio, qëndrueshmëria është kthyer në një parim në të gjithë botën. Zhvillim i qëndrueshëm do të thotë, veçanërisht për shtetet e industrializuara, të përmbahemi në kufijtë e vendosur nga mjedisi ynë natyror. Kjo është thelbësore për të siguruar që brezat e ardhshëm të mund të jetojnë jetën e tyre me dinjitet. Por zhvillim i qëndrueshëm do të thotë gjithashtu të ndërmarrësh veprime në kohën kur drejtësia globale është një çështje brenda brezit tonë të tanishëm - për shembull, duke mos shfrytëzuar fuqinë punëtore të lirë në pjesë të tjera të botës. Të mësuarit për qëndrueshmërinë është një parakusht për të përmbushur sfidat e tranzicionit në një shoqëri duke respektuar të dy këto qëllime thelbësore. Si administratorë të trashëgimisë sonë, ne duhet të synojmë të kontribuojmë në këtë.

Njohja e modeleve të zhvillimit të paqëndrueshëm

Një mënyrë për të integruar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në një ecje interpretuese është - përveç shembujve pozitivë - të identifikojë fenomenet që përfaqësojnë modele të zhvillimit të paqëndrueshëm të cilat janë globalisht të vlefshme dhe që kanë një vlerë të lartë njohjeje. Këshilli Gjerman Këshillimor për Ndryshimet Globale (EBGU) ka përcaktuar 16 **modele të tilla**.

Tre modele të zhvillimit të paqëndrueshëm

Sindroma e mbi-shfrytëzimit

Ekosistemet natyrore të një peizazhi janë mbi-shfrytëzuar.

- ⇒ Shembull në Amerikën e Jugut: shpyllëzimi i Amazonës
- ⇒ Shembull në Evropë: mbi-peshkimi në detin Mediterran

Sindroma Katanga

Një peizazh shteron nga burimet e pasura duke kaluar në një hapësirë djerrë.

- ⇒ shembull në Afrikë: minierat e bakrit, kobaltit dhe uraniumit në Kongo
- ⇒ shembull në Evropë: minierat e linjtit në Brandenburg (Gjermani)

Sindroma e Turizmit Masiv

Një peizazh është shkatërruar për arsye rekreacioni.

- ⇒ shembull në Amerikën e Jugut: lloje (specie) të huaja janë shfaqur në Ishujt Galapagos
- ⇒ shembull në Evropë: trashëgimia në rrezik në Nessebar dhe në Mont Saint Michel

Modelet gjithmonë lidhin natyrën dhe kulturën, si dhe dimensionet ekologjike, sociale dhe ekonomike. Përmes imazheve, historive dhe shëmbëlltyrave, strukturat e ndërlidhura bëhen të paharrueshme. Imazhe të forta janë për shembull, anijet e shtrira në shkretëtirë që ishin, deri në vitin 1960, në Detin Aral, i cili dikur ishte një nga katër liqenet më të mëdhenj në Tokë (Sindroma e Detit Aral). Imazhe të forta janë gjithashtu skeletet e panumërta rreth puseve të thara në zonën e Sahelit, ku njerëzit ishin nxitur të ngrinin tufa më të mëdha duke gërmuar puse më të thella që i kthyen në pluhur zonat e mëdha përmes kullotjes së tepërt dhe në të njëjtën kohë duke zvogëluar furnizimin me ujëra nëntokësor (Sahel Sindromi).

Sidoqoftë, nëse pjesëmarrësit tanë mund të frymëzohen për t'u angazhuar me këto mesazhe dhe të zgjerojnë horizontet e tyre nga shqetësimet vendase në ato globale, është një kërkesë e rëndësishme që të ketë një lidhje të fortë midis modeleve të tilla dhe fenomeneve të zgjedhura në vend.

Përpunimi i fenomeneve kryesore të qëndrueshmërisë

Për ta bërë qëndrueshmërinë të arritshme gjatë një ecje interpretuese, është e rëndësishme të gesh të paktën një fenomen përgjatë rrugës së planifikuar që përfshin të gjitha aspektet e ndryshme të qëndrueshmërisë.

Qëndrueshmëria është e rëndësishme

Ushtrim: Zbulimi i një fenomeni kyç të qëndrueshmërisë

1. Sa rëndësi ka fenomeni, si një fenomen kyç?

Deri në cilën pikë përfshihet	0	+	++	+++
Mbrojtja e pasurive natyrore?				
Ndarja e barabartë e pasurive natyrore?				
Përdorimi i kujdesshëm i pasurive natyrore?				
Veprim për të ardhmen?				
Situata në vendet e tjera?				

2. A zbulon njohuri surprizuese për marrëdhëniet e fshehura?
3. A mund të mbështetet nga vlera universale dhe imazhe të paharrueshme?
4. A ka ndonjë mesazh që e bën kompleksitetin e imazhit të paharrueshëm?
5. A ka kuptim ky mesazh për pjesëmarrësit në botën e tyre?
6. A është ky mesazh emocionues për pjesëmarrësit, edhe nëse lidhet me kontinente të tjera?
7. A i sfidon kjo temë pjesëmarrësit të rimendojnë sjelljen e tyre?



Mbrojtja e pasurive
natyrore

E shkuara, e tashmja dhe e
ardhmja
Këtu dhe diku tjetër

Ndarja e barabartë e
pasurive natyrore

Përdorimi me kujdes i
pasurive natyrore

Shembuj të fenomeneve kyçe të qëndrueshmërisë (shiko gjithashtu fq. 35)

Qëndrueshmëria: Një hambar mesjetar në një fshat

Hambari paraqet idenë e ruajtjes dhe ndarjes së ushqimit bazë, dhe të kursimit të farave për mbjellje në vitin e ardhshëm; kjo ende mund të vërehet në shumë vende.

Mesazhi: Prej shekujsh, hambarët përfaqësonin shpirtin e qëndrueshmërisë.

Paqëndrueshmëria: Vendi i një furre historike me qymyr grui në pyll

Punëtorët e qymyrit, duke punuar në kushte mizore, shpesh ezauronin lëndën drusore të pyllit ndërsa fitimet nga shitja e qymyrit arriheshin në vende shumë të largëta. Sot, shumë njerëz në Afrikë dhe Azi punojnë në situata të ngjashme.

Mesazhi: Në atë zonë, njerëzit dhe natyra kanë vuajtur për të mirën e tregjeve të largëta.

Ekziston gjithashtu një mënyrë e të mësuarit në mënyrë të qëndrueshme

Meqenëse të mësuarit për qëndrueshmëri ka të bëjë me vlerat, mënyra e trajtimit të pjesëmarrësve dhe fenomeneve luan një rol kryesor. Interpretimi i trashëgimisë mbështet këtë mënyrë të të mësuarit të orientuar drejt vlerës. Aspektet e mëposhtme janë shpjeguar tashmë në këtë manual:


- ⇒ të shoqërojmë pjesëmarrësit në vend që t'i udhëzojmë ata (fq. 13)
- ⇒ të thellohem në botën e vetë pjesëmarrësit (fq. 16)
- ⇒ të përfshijmë të gjithë personin (fq. 17)
- ⇒ për t'i dhënë fenomenit një kuptim nga këndvështrimi i pjesëmarrësit (fq. 18)
- ⇒ të ndërtojmë mbi konceptet universale (fq. 19)
- ⇒ për të kuptuar incidentet si mundësi (fq. 22)
- ⇒ të pranojmë ndërhyrje nga grupi (fq. 22)
- ⇒ për të fuqizuar pjesëmarrësit për të gjetur aksesin e tyre (fq. 23).

Edhe pse qëndrueshmëria është një temë serioze, ju lutemi mbani mend se çdo interpretim arrin më të mirë e tij kur është një proces i kënaqshëm.

Ndërlidhja e fenomeneve

... një fije kalon përmes
ajo nuk mund të hiqet
pa e zhbërë të tërën.

Johann Wolfgang von Goethe



Biseda interpretuese


- ⇒ Ndodh në një vend të vetëm
- ⇒ Merret vetëm me një fenomen
- ⇒ Përdor vetëm një mesazh

Shëtitja interpretuese

- ⇒ Lidh disa fenomene
- ⇒ Ka një mesazh kryesor dhe një mesazh për çdo fenomen
- ⇒ Ndjek një linjë të mesazhit

Interpretimi i turneut endacak

- ⇒ Ka disa fenomene dhe mesazhe të ruajtura
- ⇒ Zgjedh sipas mundësive
- ⇒ Zhvillohet nën një mesazh kryesor brenda një cikli mesazhesh



Prezantimi i mesazhit kryesor

Deri më tani, ky manual është përqëndruar rreth bisedave interpretuese: lidhja e një fenomeni të vetëm dhe mesazhi i tij për botën e pjesëmarrësve. Të planifikosh një shëtitje interpretuese do të thotë të lidhësh disa fenomene me njëri-tjetrin; dhe kjo kërkon një mesazh kryesor. Ndërsa një mesazh gjithmonë i referohet një fenomeni që mund të përjetohet në një vend specifik, mesazhi kryesor është më e përgjithshëm. Një mesazh kryesor në lidhje me temën 'Pranverë në zonën e përmytjes' mund të jetë për shembull: Pas një pushimi të gjatë, jeta në zonën e përmytjes po shikon përsëri dritë - nëse kjo mund të përjetohet me të vërtetë nga fenomene të rëndësishme në vend.

Krijimi i një linje mesazhi

Një linjë mesazhi përfaqëson një strukturë lineare. Ajo rendit të gjithë mesazhet që lidhen me fenomenet e vetme në një rend të caktuar nën titullin e një mesazhi kryesor, p.sh.:

Mesazhi kryesor: Për shekuj me radhë, prodhimi i qershisë i ka dhënë emër kësaj lugine.

1. Jeta ekonomike e fshatit ishte kjo rrugë me pemë qershie.
2. Kjo pemishte ka krijuar klimën e vet.
3. Pa një shartim të ashpër nuk mund të ketë fruta të mira.
4. Në pemët e qershisë, bletët fillojnë linja të reja prodhimi.
5. Hambari i frutave përfshin gjithçka që do ti mbajë të korrat të sigurta gjatë dimrit.
6. Koha e ka lënë pas këtë pemë qershie.

Të gjitha mesazhet e bashkangjitura fenomeneve të nënvizuara mbështeten nga disa fakte të cilat mbështeten p.sh. nga hapat kyçë ose pyetjet e hapura. Një shembull për shtjellimin sistematik të mesazhit 6 mund të gjendet në faqen 35.

Brenda linjës së mesazhit, mesazhet ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe pikat kryesore janë rregulluar në një mënyrë dramaturgjike. Duke qenë se natyra nuk sillet gjithmonë si dëshirojmë ne, kjo është shpesh më e lehtë në mjediset kulturore. Në një mjedis natyror, ndonjëherë fenomenet duhet të anashkalohen nëse tërheqin vëmendjen nga mesazhi.

Krijimi i një qarku mesazhesh

Një mënyrë për t'u larguar nga struktura lineare e një linje mesazhi është të qëndroni me pjesëmarrësit në një zonë shumë të kufizuar, të rrethuar nga fenomene të shumta që mbështesin mesazhin kryesor. Ky quhet cikël tematik. Brenda një cikli tematik nuk ka një renditje të caktuar në të cilën fenomenet duhet të vizitohen. Rendi lind nga fenomenet (për shembull, zogjtë) që shfaqen papritmas ose nga biseda me pjesëmarrësit. Për t'u përgatitur për një përvojë me kaq shpërndarje, interpretuesi njihet me të gjitha fenomenet përreth dhe mban në mend mesazhet e duhura.

Lëvizja brenda një cikli tematik quhet gjithashtu turne endacak. Ai konsiderohet të jetë arti i nivelit të lartë i udhërrëfyesit interpretues. Ai nuk mund të mësohet brenda një kursi të vetëm, por vjen kryesisht nga njohuritë dhe përvoja e interpretuesit. Ai përdoret në vende të jashtëzakonshme me një audiencë që ndryshon vazhdimisht sesa në shëtitje të rregullta interpretuese.

Shmangia e sfidës së ndjekjes së një strukture lineare është tepër joshëse, duke preferuar qasjen më liberale të turneut endacak. Sidoqoftë, ne nxisim të gjithë udhërrëfyesit interpretues që të kalojnë nëpër procesin linear dhe të ndërtuar paraprakisht për t'u mësuar me të gjitha mjetet e interpretimit personal.

Krijimi i kartave skenar të mesazheve

Një mënyrë e mirë për të zhvilluar dhe për të riorganizuar ecjet interpretuese në mënyrë të përshtatshme, është krijimi i një karte për secilin fenomen; për shembull, një kartë me mesazhin 6 (fq. 26) mund të duket kështu:

Pema frutore në rrezik

Tema: Ndryshimi i përdorimit të tokës

Fakti 1: Njëherë e një kohë, kjo pemishte arrinte deri në kodër.

- ⇒ respekt për punën e të tjerëve
- ⇒ përshkrim, fotografim historik
- ⇒ ku përfundon pëmishtja? Sa e thjeshtë ishte të kapeshin frutat?
- ⇒ formacion didaktik, përdorimi i fotografive

Fakti 2: Pema e panjës po zhduk pemën e qershisë.

- ⇒ keqardhje për pemën e qershisë, mrekulli nga natyra
- ⇒ ndryshim perspektivash, analizë
- ⇒ në çfarë mënyre ndryshojnë pemët nga njëra-tjetra?
- ⇒ formacioni individual

Fakti 3: Fruti që u rrit këtu, u përdor gjithashtu këtu.

- ⇒ kuptimi i kontekstit
- ⇒ përshkrimi (kujtim i fëmijërisë)
- ⇒ nga vijnë frutat tona? Cilat janë avantazhet / disavantazhet?
- ⇒ formacioni konference

Koha e ka braktisur këtë pemë.

Të planifikosh dhe të mbash mend rendin

*Gjeniale është aftësia për të
paraqitur të komplikuarën në
një mënyrë të thjeshtë.*

Curt Wilhelm Ceram


Në rreshtat përtej secilit prej fakteve në pjesën qendrore të kartë, renditen kuptimet e mundshme, hapat kyç, pyetjet dhe formacionet. Fenomeni përmendet në krye, mesazhi në fund.

Në të majtë mbetet një kufi më i gjerë. Nëse tani vendosim kartat e mesazheve që kemi zgjedhur për ecjen tonë interpretuese në një klip në një mënyrë që vetëm mesazhi në fund të jetë i dukshëm, dikush mund të njohë dhe ndjekë vijën e mesazhit me një shikim.

Kujtimi i aktiviteteve të lidhura me fenomene të vetme

Gjatë një shëtitje interpretuese, natyrisht, asnjë interpretues nuk do të shikonte shënimet në një skenar. Dhe siç u përmend më parë, brenda bisedave të vetme interpretuese ka rëndësi të mos ndjekësh një rend fikse të aktiviteteve. Atëherë, si mund t'i kujtojmë të gjitha këto pika të ndryshme?

Shumica prej nesh zakonisht kujtojnë imazhet dhe ngjyrat shumë më mirë se fjalët dhe numrat. Kjo ndihmon për të tërhequr të gjithë elementët në një hartë konceptesh (shih fq. 37). Një miniaturë e asaj harte mund të shërbejë si kapak i përparmë i skenarit.



Ushtrim: Zhvillimi i një harte konceptesh

Shkruajmë mesazhin kryesor në një re në qendër të një fletë të madhe letre. Mesazhet e vetme janë rregulluar në mënyrë që ato të mund të shkojnë në çdo drejtim nga reja. Asgjë tjetër nuk është shkruar në letër. Ne fillojmë të vizatojmë fenomenet dhe gjithçka që duam të përdorim ose bëjmë në lidhje me to me ngjyra të ndritshme rreth mesazheve përkatëse (për shembull, aroma e bimëve, përdorimi i një vegje, personazhet e një legjende që dëshirojmë të tregojmë). Disa ditë para shëtitjes sonë interpretuese, ne e vendosim këtë fletë diku ku mund ta shikojmë në momente të qeta, por mjaft shpesh. Përmes kësaj, imazhet dhe marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin vijnë më lehtë në mendjen tonë gjatë ecjes sonë dhe ne nuk jemi të nxitur t'i ndjekim ato në një mënyrë fikse - e cila na jep mundësinë për të hyrë në bisedë me pjesëmarrësit tanë.



Shënime praktike

Ky manual përqendrohet në metodologjinë e bisedave interpretuese dhe shëtitjeve. Sidoqoftë, të gjitha aspektet e të mësuarit kanë gjithashtu një kontekst organizativ dhe disa prej këtij konteksti duhet të paktën të preken në faqet vijuese.

Para një shëtitje interpretuese, ku dhe kur do të zhvillohet shëtitja, duhet të kontrollohet. Nuk këshillohet që të bëni shëtitje interpretuese menjëherë pas drekës, pasi rreth asaj kohe përqendrimi është zakonisht shumë i ulët. Nëse objektet që supozohet të vizitohen nuk janë gjithmonë të hapura për publikun, orari i punës duhet të konstatohet dhe nëse është e nevojshme duhet të bëhen rregullime. Brenda ndërtesave, rregulloret e sigurisë duhet të kontrollohen, ku janë tualetet dhe kush duhet të kontaktohet për mbështetje, për shembull, në rast të një aksidenti. Në përgjithësi, të gjitha miratimet duhet të merren dhe të gjitha rrugët duhet të ndiqen para se të shpallet udhërrëfimi.

Njoftimi i ecjes interpretuese përmes gazetave, fletëpalosjeve, internetit etj., duhet të përdorë një titull tërheqës ose parullë dhe një përshkrim të shkurtër, frymëzues me disa njoftime në lidhje me vendin. Duhet të shpjegojë pikën e mbledhjes, si dhe datën, dhe orët për fillimin dhe mbarimin. Jashtë dyerve, pika e mbledhjes është zakonisht një parking afër transportit publik. Datat dhe oraret duhet të koordinohen me këtë të fundit, dhe sugjerime shtesë në lidhje me nivelin e vështirësisë dhe çdo veshje apo pajisje të nevojshme duhet të jepen. Duhet të jetë e qartë nëse shëtitja do të zhvillohet në ndonjë mot të caktuar apo jo dhe cilat pajisje kërkohen. Kur për shembull, grykat, shpellat ose katedralet do të vizitohen, edhe në verë mund të jetë e nevojshme veshja e ngrohtë. Kur një shëtitje drejtohet gjithmonë nga i njëjti person, emri i saj / tij dhe një numër telefoni mund të shtohen në njoftim.

Shtrirja dhe kohëzgjatja e ecjes interpretuese duhet të zgjidhet në një mënyrë që shëtitja të mos bëhet ngjitje terreni. Ky zakonisht nuk ka problem në një ambient të brendshëm, por mund të bëhet problem në vendet e jashtme. Një qark në natyrë duhet të zgjasë jo më shumë se dy orë dhe distanca që duhet të përshkohet nga një fenomen në tjetrin duhet të jetë më pak se dhjetë minuta për të mbajtur vëmendjen e pjesëmarrësve. Kur është e mundur, rrugët e shkurtra duhet të merren parasysh paraprakisht. Udhërrëfyesi duhet të mbledhë pjesëmarrësit në intervale të shpeshta për të kontrolluar që të gjithë janë akoma atje.

Një numër pjesëmarrësish deri në rreth 15 (në varësi të objektit) është më e mira për interpretim personal, sepse më pas mund të krijohen lidhje personale të bazuara në dialog. Sa më i madh grupi, aq më pak pjesëmarrje reale do të jetë e mundur. Nëse njoftohet për një grup më të madh, ka kuptim të përfshihen më shumë se një udhërrëfyes për të mbajtur cilësinë në një nivel të pranueshëm.

Para fillimit, interpretuesi duhet të jetë i dukshëm në pikën e fillimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në vendet e mbushura me njerëz në qytete ose në muze. Kjo lejon një hapje të ngrohtë të udhërrëfimit dhe u jep pjesëmarrësve një ndjenjë sigurie. E njëjta gjë vlen për një përmbledhje të turit dhe marrëveshjen për një pikë takimi të thjeshtë për ta gjetur (ose pikën përfundimtare) në rast se dikush humbet grupin. Përveç çdo pajisje emergjence (sidomos jashtë dyerve), duhet të merret me vete një celular nëse aksesimi në rrjet është i disponueshëm gjatë ecjes. Numri i pjesëmarrësve - kur ecin në një terren të kërkuar - dhe pajisjet e tyre, si dhe aftësitë e mundshme të kufizuara, duhet të kontrollohen.

Në fillim dhe pasi udhëzuesi të prezantojë veten e tij / saj në grup në një mënyrë miqësore dhe mikpritëse, një raund i shkurtër i prezantimeve gjithashtu mund të sigurojë një pasqyrim të pjesëmarrësve dhe interesave të tyre. Në atë moment, pritshmëritë mund të mbahen në mend dhe mund të bëhen referenca të mëvonshme. Fillimi duhet t'i bëjë pjesëmarrësit kuriozë. Ai nuk duhet të zbulojë shumë, por duhet të bëjë të qartë se çfarë do të jetë ecja interpretuese. Para se grupi të fillojë në të vërtetë të lëvizë, rruga duhet të përshkruhet dhe çështjet e nevojshme të shëndetit dhe sigurisë si dhe sfidat dhe rregullat e veçanta duhet të theksohen; për shembull, ku objektet mund të preken ose ku gjurmët mund të lihen. Të gjitha njoftimet e nevojshme duhet të bëhen në një mënyrë serioze, por edhe në mënyrë pozitive, dhe ato nuk duhet të marrin shumë kohë.



Gjatë ecjes, ritmi duhet të përshtatet me atë të anëtarëve më të ngadaltë të grupit. Bisedat e vetme interpretuese nuk duhet të zgjasin më shumë se dhjetë minuta dhe afati kohor nuk duhet të zgjatet përveç nëse pajtohet me grupin. Nëse tema kritike preken vetëm me disa nga pjesëmarrësit ndërmjet bisedave aktuale interpretuese, udhërrëfyshi duhet të lidhet me ta (ose t'u kërkojë këtyre pjesëmarrësve ta bëjnë këtë) në ndalesën tjetër për t'u siguruar që pjesëmarrësit të mos marrin ndjenjën se kanë humbur diçka të rëndësishme. Gjatë shëtitjeve, pjesëmarrësit shpesh dëshirojnë të bëjnë fotografi dhe janë mirënjohës kur vihen në dijeni të objekteve të veçanta ose pikave më të mira për fotografi. Të veprosh si fotograf është një nga rolet shtesë të zakonshëm të çdo udhërrëfyshi.

Fundi i shëtitjes duhet të sigurojë një përvojë të veçantë me një përfundim të qartë për sa i përket mesazhit kryesor. Ngjarjet dhe incidentet mund të rikthehen në mendje dhe duhet të shprehen falënderime për vëmendjen dhe kontributin e pjesëmarrësve. E gjithë kjo duhet të bëhet në një vend relativisht të qetë, ku të gjithë pjesëmarrësit mund të përqendrohen te njëri-tjetri dhe te udhërrëfyshi para se grupi të fillojë të shpërndahet.

Përdorimi i sistemeve audio përforcuese gjatë aktiviteteve interpretuese

Fillimisht sistemet audio përdoren vetëm kur udhërrëfyshi dhe grupi ishin ulur dhe lëviznin së bashku, për shembull, në autobusë, trena ose anije. Ndërsa është sfiduese që një udhërrëfysh në një autobus të ruajë të gjitha cilësitë e një interpretuesi, disa ture me anije përgjatë lumenjve ose me varka me fund qelqi mbi shkëmbinj nënujorë ofrojnë mundësi vërtet të mira për biseda interpretuese; dhe për të 'humbur' zhurmën e sfondit të një motori nga një altoparlant mund të ketë shumë kuptim.

Në disa vende dikur u bë e zakonshme të përdoren folës të instaluar ose të lëvizshëm për biseda interpretuese. Sidoqoftë, rastet kur kushtet kërkojnë përdorimin e një altoparlanti për rreth 15 persona janë të rralla - dhe nëse adresohen shumë më tepër njerëz (si në amfiteatrot e disa parqeve kombëtare) as përvojat e dorës së parë dhe as dialogët nuk mund të jenë të mundshme. Ndërsa rritet numri i pjesëmarrësve, mundësitë interpretuese zvogëlohen.

Ndërsa përparon zhvillimi teknik, zgjidhjet bëhen të mundshme kur udhërrëfyshi përdor një mikrofon ndërsa të gjithë pjesëmarrësit mbajnë kufje. Kjo u jep shumë më shumë fleksibilitet anëtarëve të grupit dhe mund të ketë kuptim kur shumë udhërrëfysh veprojnë në të njëjtin vend (p.sh. në pamje të jashtëzakonshme me hapësirë të kufizuar), ku është shumë i zhurmshëm (p.sh. në disa zona të trashëgimisë industriale), ose ku supozohet që udhërrëfyshin të flasin me zë të ulët (p.sh. në kisha). Sidoqoftë, kur përdorni një sistem të tillë pa tela, për shembull, gjatë një shëtitje nëpër një qytet të vjetër, mund të jetë e vështirë të rregulloni grupet sepse pjesëmarrësit shëtisin individualisht brenda 50 metrash - ku ata janë të rrethuar nga shumë atraksione të tjera.

Ashtu si me të gjitha pajisjet teknike, udhërrëfyshi interpretues duhet të kontrollojë me kujdes se ku janë vërtet të nevojshme, dhe në cilën pikë çmimi shkon shumë lart.

Vlerësimi i një shëtitje interpretuese



Kërkojini një kolegu të vlerësojë shëtitjen tuaj interpretuese

Për të përmirësuar metodologjinë e shëtitjeve interpretuese edhe nëse nuk ka struktura trajnimi, ne rekomandojmë një mënyrë të trajnimit nga kolegët, duke përfshirë bisedat vlerësuese pas shëtitjes. Kritikën interpretuese, ku kolegët shoqërojnë njëri-tjetrin, ofrojnë një situatë të shkëlqyer fitore, sepse të dy palët mësojnë nga procesi interpretues, si dhe nga vlerësimi. Një trajner gjithashtu mund të veprojë si veshët e interpretuesit, duke dëgjuar komentet e pjesëmarrësve gjatë shëtitjes. Sidoqoftë, për të qenë të suksesshëm, interpretuesi dhe trajneri duhet të jenë të njohur me kriteret e vlerësimit (shih fq. 36).

Njoftimi i monitorimit

Edhe nëse do të vlerësohet vetëm një bisedë interpretuese, ka kuptim të bashkohemi me tërë ecjen. Një arsye është të kuptohet më mirë konteksti, tjetra është se pjesëmarrësit zakonisht janë më të shpërqendruar nga një vëzhgues në fillim. Prandaj, pjesa e parë e shëtitjes shpesh nuk është me të vërtetë përfaqësuese. Bashkimi juaj në shëtitje duhet të njoftohet në fillim sepse reagimet profesionale nuk janë të mundshme pa marrë shënime. Përveç kësaj, një trajner duhet të sillet sikur të ishte pjesëmarrës. Interpretuesi dhe trajneri nuk duhet të flasin me njëri-tjetrin gjatë shëtitjes.

Përdorimi me zgjuarsiri i kamerave

Në trajnim, kamerat mund të jenë të dobishme - edhe nëse vlerësimi i videos kërkon pak kohë. Megjithatë, për vlerësimin e një ecjeje interpretuese, ato nuk duhet të përdoren sepse shumë pjesëmarrës e kanë të vështirë t'i injorojnë ato. Regjistruesit e zërit me cilësi të lartë mund të rrisin perceptimin dhe të ndihmojnë për të kujtuar skenat më pas. Në të gjitha rastet, pjesëmarrësit duhet të bien dakord për të gjitha regjistrimet paraprakisht.

Dokumentimi i rezultateve të vlerësimit

Një seancë vlerësimi pas shëtitjes ka si qëllim përmirësimin e lehtë që interpretuesi duhet të përmbushë gjatë ecjes tjetër interpretuese. Për arsye të përgjegjësisë, kjo marrëveshje mund të shkruhet dhe të nënshkruhet nga të dy palët në pjesën e pasme të fletës së vlerësimit, e cila mbetet me interpretuesin. Përndryshe, nëse kjo nuk është rënë dakord, biseda vlerësuese është konfidenciale. Duhet të zhvillohet në një hapësirë të qetë, ku udhërrëfyesit do t'i kërkojnë së pari perceptimet e tij / saj. Reagimet duhet të jepen kryesisht në vetën e parë (duke shmangur 'Ti bëre...'), duke përshkruar më shumë sesa vlerësuar dhe theksuar më parë disa aspekte pozitive. Kritika duhet të bëhet gjithnjë miqësore, vlerësuese dhe konstruktive, duke e fuqizuar interpretuesin për të përmirësuar aftësitë e tij / saj. Meqenëse interpretimi është një lloj arti, gjërat shpesh mund të shihen ndryshe.

Fazat e kritikës interpretuese

1. Si u ndieje gjatë interpretimit?
Çfarë mendon se shkoi shumë mirë?
Ka vend për përmirësime? Nëse po, ku?
2. Mendoj se ishte mirë që...
Shikoj akoma mundësi përmirësimi në...
3. Çfarë objektive të qartë ke për ecjen tënde të radhës?

Kursi ose moduli i trajnimit për udhërrëfyesit interpretues ofron një bazë të mirë për forcimin e lidhjes midis një audience të përgjithshme joformale dhe një vendi trashëgimie, ose një koleksioni të objekteve të trashëgimisë, duke përfshirë një kopsht zoologjik ose një muze. Sidoqoftë, një kurs ose modul prej 40 orësh është shumë i shkurtër për të dhënë një përvojë të plotë dhe shumë çështje mund të preken pak. Prandaj rekomandojmë të merrni pjesë në seanca trajnimi shtesë. Në vende të ndryshme ka mundësi të ndryshme dhe drejtime të ndryshme në të cilat zhvillohen seanca të tilla trajnimi. Këtu do të japim disa sugjerime rreth asaj që mund t'ju duhet.

Interpretimi

- ⇒ turne endacak
- ⇒ interpretim në kohë reale
- ⇒ monitorim dhe vlerësim

Komunikimi

- ⇒ aftësitë komunikuese dhe retorike
- ⇒ zgjidhja e konflikteve
- ⇒ teatër i improvizuar

Grupet e synuara

- ⇒ fëmijët
- ⇒ të rinjtë
- ⇒ njerëzit vendas
- ⇒ njerëz me aftësi të kufizuara

Në varësi të fushës së punës, ka grupe të tjera të synuara që mund të jenë domethënëse në vendin tuaj. Përveç kësaj, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet kërkesave për të mësuarit për qëndrueshmëri. Kurse të përshtatshme ofrohen nga kolegjet komunitare ose organizata joqeveritare. Ju duhet të zbuloni se cilat mbështesin katër cilësitë e përmendura në faqen 10 të këtij manuali.

Megjithëse fushat në të cilat punojnë udhërrëfyesit interpretues janë përgjithësisht të mësueshme, një pjesë e madhe e suksesit tonë bazohet në pyetjen se sa të hapur jemi për të takuar pjesëmarrësit tanë dhe sa jemi të njohur me vendin për të cilin veprojmë si ambasadorë. Të bëhesh më i njohur nuk do të thotë thjesht të dish më shumë fakte, por edhe të përjetosh vazhdimisht vendin. Ne nuk ndihemi si në shtëpinë tonë në dhomën tonë të ndenjes vetëm sepse dimë shumë për materialin nga i cili janë bërë mobiljet tona. 'Shtëpia' është një ide që nuk mund të përshkruhet vetëm nga fakte. Për ta bërë vendin tonë ose objektin tonë 'shtëpinë' tonë, ne duhet të 'jetojmë' atje. Për sa i përket udhërrëfimit interpretues, kjo është arsyeja pse ushtrimet në vend janë çelësi më i mirë i suksesit.

Për disa dekada, koncepti i interpretimit të trashëgimisë është provuar shumë herë. Sidoqoftë, edhe në ambientet e jashtme të shkëlqyera, në qytete, peisazhe kulturore ose zonat e fundit të shkretëtirës Evropiane, nuk ka asnjë garanci për sukses. Ashtu si me peshkimin, gjuetinë ose mbledhjen e kërpudhave, e paparashikueshmja bën një pjesë thelbësore të apelit.

Në fund të fundit, është rezultati i të gjitha sukseseve dhe dështimeve të vogla që përmbajnë atë që ne e quajmë përvojë. Kjo është ajo që na bën të pasur.

Si vazhdohet më pas?



*Interpretimi është
një udhëtim zbulimi
në fushën e emocioneve njerëzore
dhe rritje intelektuale,
dhe është e vështirë të parashikohet
ai moment kur interpretuesi
mund të thotë me besim,
"Tani jemi plotësisht
të përshtatshëm për detyrën tonë"*

Freeman Tilden

Shtojca

Zhvillimi dhe përmirësimi i një bisede interpretuese

Për një bisedë interpretuese prej rreth dhjetë minutash, Shtojca përfshin

- ⇒ një fletë pune
- ⇒ një fletë shembull
- ⇒ një fletë vlerësimi

Plotësimi i fletës së punës mund të bëhet në hapat e renditur më poshtë; numrat në kllapa tregojnë se në cilën faqe në manual shpjegohet secili term i nënvizuar:

1. Kërkoni për një fenomen tërheqës (fq. 14 dhe 15) për një mesazh të veçantë (fq. 26).
2. Zhvilloni një mesazh të përshtatshme për këtë fenomen (fq. 18 dhe 19).
3. Zgjidhni tre fakte (fq. 18) në lidhje me fenomenin që mbështesin mesazhin dhe përfshijnë një kuptim më të thellë për pjesëmarrësit tuaj (fq. 18).
4. Merrni parasysh se cilët hapa kyçë (fq. 14 deri në 16) mund të përdoren për të sjellë në jetë faktet.
5. Merrni parasysh se si pjesëmarrësit mund të përfshihen përmes pyetjeve të hapura (fq. 17) dhe reagimeve (fq. 21).
6. Mendoni për formacionet e duhura (fq. 20) dhe ku fenomeni ofron një zbulim emocionues (fq. 17).

Nëse biseda interpretuese është pjesë e një turi të drejtuar, fleta e vlerësimit mund të përdoret së bashku me stërvitjen me kolegëve si bazë për seancën e vlerësimit. Ju do të gjeni informacione rreth kësaj në faqen 29.

Provimi praktik i kursit të certifikimit bazohet në fletën e vlerësimit. Plotësimi i fletës së punës mund të jetë shumë e dobishëm për të eksploruar elementë të ndryshëm dhe për të dalë me ide të reja. Sidoqoftë, dialogu me pjesëmarrësit është thelbësor, lista e fakteve në fletë nuk ka rëndësi, dhe për sa kohë që mesazhi është i qartë, jo të gjitha idetë duhet të vihen në vend.

Shumë interpretues e kanë parë të dobishme të hartojnë fletën e punës për praktikimë. Interpretuesit që prirën të veprojnë në një mënyrë më krijuese duhet ta detyrojnë veten të plotësojnë fletën të paktën një herë. Interpretuesit që prirën të jenë shumë të organizuar nuk duhet t'i përmbahen shumë një rutine. Një bisedë interpretuese është një pjesë arti. Strukturimi i tepërt mund ta prishë atë.

Diçka përsa i përket hartave të koncepteve

Në faqen 37, Shtojca përfshin një shembull për një hartë konceptesh në mënyrë që të zhvillojë një tabelë të vizualizuar të përmbajtjes për një shëtitje interpretuese (shih fq. 27). Ju lutemi vini re se kjo hartë e koncepteve ka të bëjë më shumë me imazhet sesa me fjalët; dhe në të vërtetë origjinali është një version shumë i gjallë. Mundohuni të shmangni hartat e koncepteve që përbëhen kryesisht nga fjalë. Përveç organizimit të informacionit, ideja themelore e një harte konceptesh është që shumëllojshmëria e imazheve mund të mbahet mend shumë më mirë sesa përbërja e fjalëve. Të zvogëlosh hartën tënde të koncepteve në fjalë kyçe do të thotë të humbasësh shumë nga vlera e saj.

Renditja e fakteve nuk është fikse, dhe hapat e kyç dhe pyetjet e hapura nuk duhet të përdoren të gjitha në fund. Por është e rëndësishme që mesazhi të mbetet i dukshëm.

Fletë pune biseda interpretuese

Zhvillimi i një bisede interpretuese (fletë pune)

Fenomeni	Çështja	mesazhi (një fjali e plotë, e cila në këtë rast përmban një koncept universal)

Tema është 'fari' që ju drejton. Faktet tuaja mbështesin mesazhin që ju doni që të përcillni dhe mund të përfetohen në këtë vend.

1. fakt (si një fjali)	kuptimi (çfarë të zgjon...)	hapat kyç (metodat)	pyetjet e hapura	formacioni i grupit dhe mjetet

2. fakt (si një fjali)	kuptimi (çfarë të zgjon...)	hapat kyç (metodat)	pyetjet e hapura	formacioni i grupit dhe mjetet

3. fakt (si një fjali)	kuptimi (çfarë të zgjon...)	hapat kyç (metodat)	pyetjet e hapura	formacioni i grupit dhe mjetet

Sekuenca e ngjarjeve nuk është e detyrueshme dhe nuk keni nevojë të përdorni të gjithë hapat kyç dhe pyetjet e hapura që keni punuar paraprakisht. Qëllimi juaj është të filloni një bisedë me pjesëmarrësit tuaj sa më shpejt të jetë e mundur. Prej atëherë, duhet të ndiqni çdo çështje që ngrihet. Por gjithmonë duhet ta keni parasysh mesazhin që donit të përcillni dhe emocionin që doni të zgjoni.

Fleta shembull biseda interpretuese

Fenomeni në këtë fletë shembull është një pemë e vjetër qershie që po e mbulon një pemë e gjatë panje, sepse një ish-kopsht po mbingarkohet nga një pyll i vetë-mbjellë së fundmi.

phenomenon	topic	theme (a complete sentence, which in this case contains a universal)		
threatened fruit tree	changing land use	Time left this cherry tree behind. (universals: change, isolation)		
The theme is the 'lighthouse' you are heading for. Your facts support your theme and can be experienced on site.				
1. fact (as one sentence)	meaning (It arouses ...)	stepping stones	open-ended questions	formation / props
At one time, the orchard reached far up the hill.	respect for the work of others	description, historic photograph	Where does the orchard end? How easy was it to gather the fruit?	didactic formation, using photograph
2. fact (as one sentence)	meaning (It arouses ...)	stepping stones	open-ended questions	formation / props
The maple tree is wiping out the cherry tree.	regret for the cherry tree, awe of nature	change of perspectives, analysis	In what way do the trees differ from each other?	individual task formation
3. fact (as one sentence)	meaning (It arouses ...)	stepping stones	open-ended questions	formation / props
Fruit that grew here was also used here.	understanding of context	narration (childhood memory)	Where does our fruit come from? What are the (dis)advantages?	conference formation

Zhvillimi i një bisede interpretuese (fletë vlerësimi)


1. Performanca e interpretuesit	0	+	++	+++	Komente
A tregoi entuziazëm interpretuesi?					
A ishin të kuptueshme të gjitha çështjet e tij?					
A ishte i besueshëm interpretuesi dhe a ishte i saktë i gjithë informacioni i tij?					
A i mori interpretuesi bindshëm mesazhet e saj / tij?					
A përdori interpretuesi vazhdimisht gjuhën e duhur të folur dhe të trupit?					
2. Vlerësimi i fenomenit	0	+	++	+++	Komente
Në përgjithësi a ishte biseda interpretuese e përqendruar në fenomen?					
A u theksuan cilësitë unike të fenomenit?					
A mund të verifikohen të gjitha faktet në vend?					
A u formua mirë grupi në lidhje me fenomenin?					
A kishte ndonjë zbulim interesant?					
3. Përfshirja e pjesëmarrësve	0	+	++	+++	Komente
A ishin të gjithë pjesëmarrësit të përqendruar gjatë gjithë kohës?					
A përfshinte ky prezantim përvojat e drejtpërdrejta me fenomenin?					
A u inkurajuan pjesëmarrësit nëpërmjet pyetje të hapura?					
A kishin pjesëmarrësit mundësinë të tregonin për diçka nga jeta e tyre e përditshme?					
A ishte në gjendje interpretuesi të merrte ndërhyrje konstruktive nga grupi?					
4. Gjurmimi i temës	0	+	++	+++	Komente
A ishte mesazhi dhe tema e qartë? Nëse thoni 'po', si ishte formuluar ajo.					
A qëndronte ky mesazh në zemër të çështjes?					
A u konsideruan faktet dhe kuptimet prej tyre në një mënyrë të ngjashme?					
A janë përdorur hapa kyç (metoda) të ndryshëm?					
A e inkurajoi biseda interpretuese vlerësimin dhe respektin për trashëgiminë drejtpërdrejt apo indirekt?					

Fleta e vlerësimit ka për qëllim të mbështesë procesin e trajnimit nga kolegët. Nuk ka të bëjë me shënjimimin. Propozimet për vlerësim duhet të jenë transparente; komentet duhet të jenë të menduara dhe të qarta.

Fleta e
vlerësimit
biseda
interpretuese

Harta e koncepteve për një shëtitje interpretuese

Kjo hartë e koncepteve ilustron linjën e mesazhit të përshkruar në faqen 26. Originali përdor shumë ngjyra. Për të mbajtur në mendje imazhin, përpikuni të shmangni fjalët dhe mbajeni hartën tuaj të koncepteve sa më ilustruese dhe me sa më shumë ngjyra të jetë e mundur. Është vetëm për ju.



Trekëndëshi i interpretimit (fq. 9 dhe 11)

Një model konceptual i interpretimit i përbërë nga (1) fenomeni, (2) pjesëmarrësit dhe (3) interpretuesi (ose mënyrat interpretuese) përqendruar në një mesazh.

Fenomeni (fq. 14 dhe 15)

Diçka që është e kuptueshme si ndjesi në vend. Është e rëndësishme të theksohet karakteri i saj i vetëm - për shembull, 'personaliteti' i një peme ose një ndërtese sesa përkatësia e saj në një specie apo stil ndërtimi.

Tema (fq. 26)

Tema e klasifikon fenomenin, për shembull, si 'një halore' ose si 'një ndërtesë e Rilindjes'. As nuk përmban një deklaratë përshkruuese dhe as nuk i jep një kuptim (shih më poshtë) fenomenit të vetëm.

Mesazhi (fq. 18 dhe 19)

Ky është 'fari' drejt të cilit po shkoni. Një mesazh është i lidhur me një kuptim (shih më poshtë). Ai shprehet si një fjali e plotë, duke marrë në thelb çështjen; shpesh sepse përmban një temë universale (shih më poshtë).

Fakt (fq. 18)

Një deklaratë faktike; p.sh. 'Vidrat mund të udhëtojnë gjatë natës'. Faktet duhet të mbështesin gjithmonë domethënien e fenomenit autentik si dhe mesazhin.

Kuptimi (fq. 18)

Kjo është mënyra se si një fenomen mund të shkaktojë një reagim emocional tek pjesëmarrësit - të tilla si frika, çudia, kurioziteti, habia, pikëllimi, zemërimi. (Nuk nënkupton kontekstin intelektual këtu.)

Universal (fq. 19)

Një koncept kuptimplotë që prek vlerat dhe shqetësimet e pothuajse çdo personi në botë, të tilla si familja, miqësia, tragjedia, dhimbja, ndryshimi, kujdesi, liria dhe robëria, dashuria dhe urrejtja, jeta dhe vdekja.

Hapat kyç (strategjik) (fq. 14 deri 16)

Një mjet metodik ose retorik që lehtëson hyrjen në njërën nga cepat e trekëndëshit interpretues (shih më lart). Një eksperiment mund të jetë një hap metodik ndërsa një krahasim mund të jetë një hap retorik.

Pyetjet e hapura (fq. 17)



Kjo është një pyetje me një përgjigje të paparashikueshme, për shembull, "Çfarë vendi të kujton ajo erë?" ose "Si mund të duket kjo luginë në 50 vjet?"

Mjete ndihmëse (lehtësuese) (p. 21)

Sendet lehtësuese mund të mbështesin aktivitete interpretuese. Ato përfshijnë, për shembull, kostume, syze zmadhuese, dylbi, detektorë lakuriqësh.

Formacione (fq. 20)

Kjo është mënyra se si pjesëmarrësit tuaj vendosen në një vend, për shembull, përballë jush ose në një rreth. Zakonisht është mirë që ju, pjesëmarrësit tuaj dhe fenomeni juaj të formoni një trekëndësh. Ndryshimi i formacionit shpesh prodhon zbulime të papritura, një element i rëndësishëm në interpretim.



Udhërrëfyesit punojnë në zona të ndryshme të trashëgimisë: në zona të mbrojtura dhe ndërtesa historike, në muze, kopshte zoologjike dhe kopshte botanike. Ata janë të përkushtuar për të sjellë trashëgiminë tonë në plan të parë dhe për të kërkuar mënyrat më të mira për të menaxhuar të ardhmen tonë.

Ky manual bazohet në përvojën e grumbulluar prej udhërrëfyesve nga e gjithë Evropa. Ai përmban material përgatitor për kurset e trajnimit për udhërrëfyes interpretativ të certifikuar. Ky trajnim, i cili zhvillohet në 40 orë, mund të zhvillohet dhe si një seminar i pavarur ose si një modul i një kursi tjetër trajnimi. Brenda projektit HeriQ, ky modul u testua në trajnime të zhvilluara në disa shtete dhe më pas u përgatit ky manual, i cili sot gjendet i përkthyer në mbi dymbëdhjetë gjuhë të ndryshme. Për të përmirësuar cilësinë e këtij manuali interpretimi, ne do ta vlerësojmë nëse punonjësit e site-ve turistike, natyrore apo ata që punojnë në site të trashëgimisë kulturore, e provojnë qasjen që sjell ky material, dhe do të vlerësojmë maksimalisht çdo sugjerim që ata mund të na dërgojnë, i cili do të ndihmonte zhvillimet cilësore në këtë fushë.

